

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5535
E mërkurë, 25 korrik 2018
çmimi 0.40 €

Bill Clintoni ia dha fjalën
Ekrem Bardhës se do ta
ndalte gjenocidin në Kosovë

FAQE 12-13



Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,
Fitues i Antenës së Artë / Mjeshtër i Madh

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SALI ASLLANAJ ■ FAQE 4-5

LDK-ja është për dialog, por jo për këtë format

Anëtar i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sali Asllanaj, ka bërë me dije se kjo parti nuk e mbështet formatin aktual të dialogut të udhëhequr nga presidenti Hashim Thaçi. "LDK-ja është për dialog, por jo për këtë format dhe është kundër udhëheqjes së këtij procesi nga presidenti Thaçi. Ky është qëndrim zyrtar dhe i pandryshueshëm", ka thënë Asllanaj në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re". Ai ka vlerësuar se konsensusi politik për dialogun me Serbinë duhet të arrihet në Kuvend e jo nëpërmjet institucioneve të tjera. Asllanaj ka theksuar se strukturat më të larta të LDK-së kanë pasur takime me faktorin ndërkombëtar, të cilit i kanë prezantuar qëndrimin e kësaj partie për dialogun. Ai e ka quajtur të vështirë arritjen e këtij konsensusi për këtë proces por, sipas tij, nuk është i pamundur



Presidenti fton sërish partitë parlamentare të përfshihen në dialog



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për medie mbajtur të martën, ka thënë se partitë politike dhe Kuvendi i Kosovës janë duke u vonuar për t'i marrë përgjegjësitë e veta kushtetuese në lidhje me dialogun me Serbinë. Ai i ka ftuar sërish partitë parlamentare që të përfshihen në dialog. "Kërkoj nga partitë parlamentare t'i marrin përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore, mirëpo po më vjen keq që janë duke u vonuar e koha po ecën", ka thënë Thaçi ■ FAQE 3

Policia themelon task forcë për parandalimin e aksidenteve në trafik

Qëllimi kryesor i kësaj task force është që nëpërmjet komandës dhe kontrollit të ndikohet në parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor, duke angazhuar sa më shumë personel policor nga niveli qendror dhe ai lokal, duke përfshirë edhe stafin udhëheqës të policisë ■ FAQE 7



AKTUALE

**A DO TË BËHET AGIM BAHTIRI
SI ISA BOLETINI PASI RAMIZ
KELMENDI NUK U BË SI
ÇERÇIZ TOPULLI** ■ F. 13

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



**LIMAJ FALËNDERON
BIZNESET E DIASPORËS PËR
PROMOVIMIN E PRODHIMEVE
TË KOSOVËS** ■ F. 7

**PRISHTINA, NGA VJESHTA,
ME KAMERA TRAFIKU** ■ F. 6

EKONOMI

**IMPORTI RRIKET PËR 20 PËR
QIND NË KRAHASIM ME VITIN
E KALUAR** ■ F. 8

**5 000 PUNËTORË TË KEK-ut
DO T'I PËRDORIN SHËRBIMET
MË TË REJA TË VALËS** ■ F. 8

SPORT

**ELEZAJ: DUKAGJINI, I
VENDOSUR PËR SUPERLIGË** ■ F. 16

**KALENDARI I LA LIGËS,
BARÇA - REALI TAKOHEN MË
28 TETOR** ■ F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, është pritur të martën në takim nga presidentja e Senatit italian, Maria Elisabetta Alberti Casellati

Veseli: Italia mbështet liberalizimin e vizave

Presidentja e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, ka theksuar se shteti i saj do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën si në rrafshin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ndërshtetërore, po ashtu edhe në kuadrin e Bashkimit Evropian, sidomos në proceset aktuale që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave dhe proceset e tjera integruese



PRISHTINË, 24 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, në kuadër të vizitës zyrtare në Itali, është pritur të martën në takim të veçantë nga presidentja e Senatit italian, Maria Elisabetta Alberti Casellati, me të cilën ka diskutuar për mbështetjen politike të shtetit italian për heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës brenda këtij viti. Gjatë këtij takimi të dy homologët diskutuan edhe për marrëdhëniet e shkëlqyeshme që Roma dhe Prishtina zyrtare kanë ndërtuar ndërmjet tyre.

Veseli e ka njohur kryeparlamentaren italiane për zhvillimet në Kosovë, me fokus në agjendën evropiane si prioritet kombëtar. Veseli e ka falënderuar Casellatin për përkrahjen e vazhdueshme që shteti italian i

ka dhënë dhe është duke i dhënë Republikës së Kosovës në të gjitha drejtimet, ndërsa ka kërkuar mbështetjen e Senatit dhe shtetit italian në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se institucionet e vendit kanë përmbyshur të gjitha kriteret që atyre u janë vendosur në këtë proces, ndërsa përmbyshja e të gjitha kriterëve është vlerësuar ditë më parë edhe nga Komisioni Evropian i cili rekomandon heqjen e shpejtë të vizave për qytetarët e Kosovës. Ndërsa presidentja e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, ka theksuar se shteti i saj do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën si në rrafshin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ndërshtetërore, po ashtu edhe

në kuadrin e Bashkimit Evropian, sidomos në proceset aktuale që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave dhe proceset e tjera integruese. "Ne në Itali jemi në anën tuaj. Jemi të gëzuar që ka pasur hapa pozitivë në këtë drejtim. Do të përpiqemi të

influencojmë pozitivisht në vendet e Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave. Ne vlerësojmë reformat në sistemin e drejtësisë që janë bërë deri më tani. Më vjen mirë që opozita flet me të njëjtën gjuhë si pozita për një interes kaq madhor si

liberalizimi i vizave", ka thënë Casellati.

Bashkëbiseduesit janë pajtuar se marrëdhëniet midis dy parlamenteve të hyjnë në një dinamikë të re, në të gjitha nivelet e bashkëpunimit ndërparlamentar.

Qeveria shqiptare propozon tre gjyqtarë për Gjykatën e Strasburgut



TIRANË, 24 KORRIK - Pozicion i gjyqtarit të Shqipërisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut është ende vakant, pasi lista me kandidatë të propozuar nga Qeveria shqiptare është refuzuar disa herë për shkak të pastërtisë së figurave. Ekzekutivi shqiptar ka hartuar një listë të re ku rekomandon tre kandidatë për pozicionin në fjalë. Ata janë Darian Pavli, Marjana Semini dhe Sokol Berberi. Mësohet se emrat e tyre u përzgjodhën nga komisioni

ad-hoc mes 16 aplikantëve që përmbyshnin kriteret e shpallura në njoftimin për aplikim.

Vlerësimi për secilin prej kandidatëve u bë duke u bazuar në një sistem pikëzimi prej 100 pikësh në total, me një përkatësi prej 30 pikësh për dosjen e çdo aplikanti dhe 70 pikësh për intervistën.

Të tre kandidatët e rekomanduar iu përgjigjën me shumë saktësi të gjitha pyetjeve të drejtuara nga komisioni ad-hoc gjatë intervistës, në gjuhën shqipe dhe në

anglisht, duke spikatur për njohje të thelluar të jurisprudencës së GJEDNJ-së, mënyrës së funksionimit të GJEDNJ-së dhe rolit të gjyqtarit në GJEDNJ. Lista me tre kandidatët u dërgua për konsultim, mbi përshtatshmërinë e kandidatëve, pranë Panelit Këshillues të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe të martën i është dërguar Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për procedura të mëtejshme.

Osmani: Referendum i suksesshëm, hapa drejt BE-së dhe NATO-s

SHKUP, 24 KORRIK - Zëvendëskryetari i Maqedonisë për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, mbajti të martën një takim me ministrin Shtetëror gjerman për Evropën, Mihael Rot.

Zëvendëskryeministri Osmani fillimisht shprehu mirënjohje për mbështetjen dhe përkushtimin e vazhdueshëm të Gjermanisë në procesin e aderimit në

Bashkimin Evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, reflektuar edhe përmes iniciativës "Procesi i Berlinit", thuhet në komunikatë.

Osmani u përqendrua edhe në rëndësinë e periudhës në të cilën gjendet Maqedonia në rrugën eurointegruese, në kontekst të vendimit të mëhershëm të Këshillit të Evropës për kornizë kohore prej 12 muajsh, apo qer-

shor të vitit 2019, për fillimin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Më pas, fokusi u vendos në përgatitjen e negociatave përmes procesit të skriningut si dhe thellimin e reformave dhe dhënien e rezultateve konkrete në pjesën e gjyqësorit, shërbimet e sigurisë, administratës publike duke mos e anashkaluar edhe luftën kundër krimit të organizuar dhe

korupsionit si dhe të gjitha fushat e tjera kyçe. Në kontekst të referendumit të paralajmëruar, tha se referendum i suksesshëm do të thotë një hap para drejt BE-së dhe NATO-s. "Jemi të vetëdijshëm për kompleksitetin e procesit, që përfshin një pjesë të madhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian, i cili duhet të transpozohet në legjislacionin nacional, por këto janë përfitime që çojnë drejt



transformimit themelor të vendit në shoqërinë demokratike evropiane, me një treg funksional ekonomik, institucione efektive dhe administratë profesionale", tha Osmani.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për media

Presidenti fton sërish partitë parlamentare të përfshihen në dialog

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një konferencë për medie mbajtur të martën, ka thënë se partitë politike dhe Kuvendi i Kosovës janë duke u vonuar për t'i marrë përgjegjësitë e veta kushtetuese në lidhje me dialogun me Serbinë. Ai i ka ftuar sërish partitë parlamentare që të përfshihen në dialog. "Kërkoj nga partitë parlamentare t'i marrin përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore, mirëpo po më vjen keq që janë duke u vonuar e koha po ecën", ka thënë Thaçi

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u ka bërë sërish thirrje partive parlamentare që t'i marrin përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore në fazën përmbyllëse të dialogut me Serbinë që po zhvillohet në Bruksel, me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Në një konferencë për media mbajtur të martën, presidenti Thaçi ka thënë se Kosova në këtë fazë përmbyllëse të dialogut, normalizimi i marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë do të bëhet përmes njohjes reciproke si dy shtete të pavarura dhe sovranë. "Gjithmonë kam kërkuar që edhe Kuvendi të jetë i përfshirë drejtpërdrejt në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kërkoj nga partitë parlamentare që t'i marrin përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore, mirëpo

po më vjen keq që janë duke u vonuar e koha po ecën", ka thënë presidenti Thaçi.

Ai ka shtuar se në fund të procesit Kuvendi i Kosovës do të jetë institucioni që do të vendosë, pasi që marrëveshja fuqizohet vetëm nëse ratifikohet nga Kuvendi. "Edhe ftesa ime edhe për partitë politike, institucionet shtetërore mendoj se do të ishte që të pajtohemi për një pako të veprimeve të sinkronizuara të interesit shtetëror në agjendë dhe kohë, duke përfshirë dialogun për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi, arritjen e marrëveshjes, votimin në Kuvend dhe zbatimin e marrëveshjes", ka theksuar Thaçi. Ai ka kërkuar që spektri politik në Kosovë të reflektojë në këtë proces, duke nënvizuar se në agjendën shtetërore nuk duhet të ketë pozitë dhe opozitë. "Mendoj se nuk duhet të bëhet ndonjë kauzë në betejën e spektrit politik çështja e normalizimit të raporteve me Serbinë. Kështu



që, besoj se spektri politik do të reflektojë dhe do t'i bashkëngjitet këtij përkushtimi të institucioneve të vendit", ka deklaruar presidenti Thaçi. Aktualisht Kosova dhe Serbia janë futur në atë që cilësohet si faza finale e dialogut, në të cilën është paralajmëruar edhe arritja e një marrëveshjeje finale që do ta nënkuptonte normalizimin e raporteve ndërmjet dy vendeve. Presidenti u shpreh se Kosova nuk ka kohë për eksperimente, për turbulencë politike, duke iu referuar pyetjes se opozita është

duke dashur të bëjë një mocion mosbesimi për Qeverinë e Kosovës. "Si asnjëherë më parë Kosovës i duhet unitet, përgjegjësi e lartë e bartësve politikë. Asnjë proces nuk mund të arrihet pa një konsensus", ka thënë ai. Në këtë konferencë Thaçi ka folur edhe rreth rekomandimit pozitiv nga Komisioni Evropian për liberalizimin e vizave. Sipas tij, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian nuk duhet të shqetësohen sepse, siç ka thënë ai, qytetarët e Kosovës nuk do ta keqpërdorimin liberalizimin.

"Shtetet anëtare (të BE-së) nuk duhet të kenë asnjë mëdyshje apo hezitim, shqetësim, sepse institucionet e Kosovës do ta bëjnë fushatën e duhur për t'i informuar drejt qytetarët se çfarë nënkupton liberalizimi, cilat janë mundësitë dhe cilat janë kufizimet", ka thënë Thaçi. Edhe presidenti Thaçi ka thënë se qytetarët dhe institucionet e Kosovës janë të edukuara për kuptimin e këtij procesi, marrë parasysh faktin se Kosova ka zbatuar më tepër kritere sesa vendet e tjera të rajonit.

Kosova dhe Italia thellojnë bashkëpunimin në siguri dhe mbrojtje

ROMË, 24 KORRIK (ER) - Zëvendësministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjeneralletjënant Rahman Rama, kanë qëndruar për vizitë dyditore në Romë. Delegacioni i MFSK-së është pritur nga niveli i lartë i Qeverisë italiane dhe Forcat e Armatosura të Italisë. Në takimin e zëvendësministrit Ramadani dhe komandantit Rama me zëvendësministrin italian të Mbrojtjes, Raffaele Volpi, u diskutua për objektivat e Kosovës për anëtarësim në NATO, thellimin e bashkëpunimit dypalësh me Italinë, arritjet e FSK-së, planin gjithëpërfshirës për transformimin e FSK-së në ushtri, si dhe për vullnetin e Kosovës për t'i dërguar trupat e FSK-së në ndihmë të popujve në zona të ndryshme të krizave nëpër botë.

Gjithashtu, më 23 korrik delegacioni i MFSK-së është pritur nga nënadmiralet Giuseppe Dragone, komandant i Shtabit të Përbashkët Italian të Operacioneve. Delegacioni i FSK-së me nënadmiralet Dragone kanë diskutuar për mundësitë e thellimit të bashkëpunimit dhe angazhimet e përbashkëta ndërmjet Kosovës dhe Italisë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes si dhe për gatishmërinë e Kosovës për të marrë pjesë në Operacione Paqeruajtëse nëpër botë krahas Forcave të Armatosura Italiane. Delegacioni i MFSK-së ka zhvilluar vizitë edhe në Ministrinë e Jashtme të Italisë me drejtorin për Ballkanin Perëndimor dhe drejtorin për NATO ku, ndër të tjera, me zyrtarët e MPJ-së u diskutuan marrëdhëniet e Kosovës me Italinë dhe me NATO-n.



Flet për "Epokën e re", Sali Asllanaj

LDK-ja është për dialog,



Anëtari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sali Asllanaj, ka bërë me dije se kjo parti nuk e mbështet formatin aktual të dialogut të udhëhequr nga presidenti Hashim Thaçi. "LDK-ja është për dialog, por jo për këtë format dhe është kundër udhëheqjes së këtij procesi nga presidenti Thaçi. Ky është qëndrim zyrtar dhe i pandryshueshëm", ka thënë Asllanaj në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re". Ai ka vlerësuar se konsensusi politik për dialogun me Serbinë duhet të arrihet në Kuvend e jo përmes institucioneve të tjera. Asllanaj ka theksuar se strukturat më të larta të LDK-së kanë pasur takime me faktorin ndërkombëtar, të cilit i kanë prezantuar qëndrimin e kësaj partie për dialogun. Ai e ka quajtur të vështirë arritjen e këtij konsensusi për këtë proces por, sipas tij, nuk është i pamundur

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Asllanaj, ka ndryshuar qëndrimi i LDK-së karshi dialogut me Serbinë?

Asllanaj: Më herët është takuar Kryesia e LDK-së dhe ka biseduar për këtë punë. Kemi dalë me qëndrim zyrtar: LDK-ja është për dialog, por jo për këtë format dhe është kundër udhëheqjes së këtij procesi nga presidenti Thaçi. Ky është qëndrimi ynë zyrtar dhe i pandryshueshëm.

"Epoka e re": LDK-ja e pati votuar Thaçin për president pikërisht në kohën kur flitej se dialogu do të udhëhiqej nga presidentët.

Asllanaj: Mendoj se ky arsytim nuk është i qëndrueshëm sepse LDK-ja ka votuar Thaçin për presidentin kur Mustafa është votuar për kryeministër. Kjo ka

qenë në kuadër të marrëveshjes e cila nuk ka qenë e përhershme.

"Epoka e re": Pavarësisht prej refuzimit të LDK-së për ta mbështetur dialogun në vazhdimësi, po bëhet thirrje për arritjen e konsensusit për këtë proces.

Asllanaj: Për tema të mëdha kombëtare gjithmonë duhet të ketë konsensus, por ky konsensus duhet të arrihet në Kuvend e jo përmes institucioneve të tjera, sepse Kuvendi është organi më i lartë në Kosovë.

"Epoka e re": Besoni se mund të arrihet ky konsensus?

Asllanaj: Së paku me LDK-në mund të arrihet konsensusi, kurse për partitë e tjera nuk mund të garantoj. LDK-ja gjithmonë ka qenë bashkëpunuese kur i është kërkuar për procese

të mëdha.

"Epoka e re": Opozita nuk po e përkrah këtë format dhe këtë udhëheqje të dialogut. Ka kohë që të ketë ndryshime në këtë drejtim?

Asllanaj: Nëse ka vullnet gjithmonë gjendet koha, por nëse nuk ka vullnet gjenden justifikime të ndryshme. Në Kuvend do të mund të arrihet konsensusi si dhe të ndërtohet një platformë me vija të qarta se çfarë duam nga dialogu me Serbinë. Për këtë proces duhet një bashkëpunim i shumicës së forcave politike në vend.

"Epoka e re": Një platformë për dialog është tërhequr nga Kuvendi për shkak të mungesës së konsensusit.

Asllanaj: Ajo ka qenë platformë shumë e zbrazët dhe pa asnjë koncept. Qëllimi kryesor i saj

por jo për këtë format



"Epoka e re": *Si e sheh tash e tutje LDK-ja vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi?*
Asllanaj: Bisedimet me Serbinë janë të pashmangshme sepse, tekefundit, jemi fqinjë dhe problemet duhet t'i zgjidhim me dialog dhe gjithnjë duke e mbrojtur interesin e Kosovës, meqë variantet e tjera janë të këqija. Kjo mund të arrihet pikërisht me anë të një bashkëpunimi të gjerë në mes të forcave kryesore politike dhe me një platformë të qartë. Mosarritja e një bashkëpunimi të tillë ndoshta është si pasojë e bashkëpunimeve të mëhershme të cilat nuk kanë qenë të sigjerta dhe janë shikuar me dyshime permanente. Këto dyshime e kanë bazën nga mosbashkëpunimi i sigjertë në të kaluarën. Tash duhet të punohet gjatë për ta kthyer besimin reciprok, sepse kur nënshkruhen marrëveshjet duhet të zbatohen. LDK-ja në vazhdimësi i ka zbatuar marrëveshjet edhe atëherë kur Thaçi është votuar për president, por pas një periudhe të shkurtër PDK-ja ka votuar pro rrëzimit të Qeverisë Mustafa. Sido që të jetë, LDK-ja është për arritjen e konsensusit, por jo për këtë format dhe për këtë udhëheqje të dialogut.

"Epoka e re": *Meqë nuk po e pranoni Thaçinin në krye të dialogut, keni ndonjë emër i cili mund të zëvendësojë atë?*
Asllanaj: Jo. LDK-ja mendon se Qeveria duhet ta udhëheqë dialogun sepse Kuvendi kontrollon Qeverinë. Pastaj Qeveria do të mund të krijonte një delegacion gjithëpërfshirës për t'i zhvilluar bisedimet me Serbinë. Gjithmonë, së paku në ratifikimin e marrëveshjeve, Kuvendi e ka fjalën e fundit dhe LDK-ja e mban të drejtën që në Kuvend ta thotë fjalën e vet, por në këtë momentum grupi parlamentar nuk e pranon bartjen e dialogut nga Qeveria tek presidenti.

"Epoka e re": *Duke mos e përkrahur dialogun dhe duke mos u bërë pjesë e tij, a po përpiqet LDK-ja ta heqë përgjegjësinë e këtij procesi?*
Asllanaj: Përgjegjësia është institucionale dhe LDK-ja në Kuvend, si partia më e madhe opozitare, e bart përgjegjësinë e vet kur kjo çështje do të vijë për diskutim. LDK-ja nuk mund të marrë përgjegjësi që nuk i takojnë. Do t'i marrim përgjegjësitë që na takojnë si grup parlamentar karshi forcës

politike që kemi, pra as më tepër e as më pak.

"Epoka e re": *Keni pasur takime me faktorin ndërkombëtar për t'ia bërë të qartë se LDK-ja nuk e përkrah në asnjë rrethanë këtë format të dialogut?*
Asllanaj: Strukturat më të larta të LDK-në kanë pasur takime me faktorin ndërkombëtar ku është prezantuar qëndrimi ynë për dialogun.

"Epoka e re": *Ju po thoni se konsensusi duhet të arrihet në Kuvend për çështjen e dialogut dhe çështjet e tjera, por Kuvendi nuk është duke funksionuar si duhet në mungesë të kuorumit. Është LDK-ja ajo që po i bojkoton seancat kohët e fundit.*
Asllanaj: Gjithmonë po kërkohet nga LDK-ja që të sakrifikohet për interesa të Kosovës, por duke i shkelur disa parime të saj, si dhe duke i dëshpëruar shpeshherë edhe votuesit. LDK-ja do të veprojë në bazë të përgjegjësisë të veta, por gjithmonë duke mos pretenduar që ne do ta bëjmë kuorumin në Kuvend. Partitë në pushtet e kanë për obligim ta sigurojnë kuorumin, pastaj eventualisht për tema të

mëdha do të duhej të kërkojnë përkrahjen e opozitës. Mirëpo jo në këtë formën siç po pretendohet të ndodhë tani, që Qeveria e pakicës të udhëheqë, kurse LDK-ja t'i kryejë punët e të tjerëve.

"Epoka e re": *Koalicioni qeverisës nuk po sillet si duhet karshi opozitës?*
Asllanaj: E kaluara e ngarkon shumë raportin në mes të subjekteve politike dhe kjo është fatkeqësi. Megjithatë, duhet të arrihet konsensusi në mes të partive kryesore në mënyrë që proceset e mëdha të kalojnë pa dhimbje, por jo duke e injoruar opozitën dhe LDK-në si forcën kryesore politike në vend.

"Epoka e re": *Meqë proceset e mëdha nuk po shkojnë ashtu siç po kërkon LDK-ja, a do të inicioni mocion të mosbesimit?*
Asllanaj: LDK-ja që disa muaj është duke e analizuar mundësinë që përmes mocionit të mosbesimit ta shkarkojë Qeverinë, por aktualisht nuk janë votat e mjaftueshme. LDK-ja nuk është e interesuar të bëjë një mocion dhe të dështojë. Në momentin që shohim se ky mocion mund të kalojë, do ta iniciojmë.

"Epoka e re": *Si mund të shkohet në zgjedhje kur nuk i keni numrat për ta rrëzuar Qeverinë?*
Asllanaj: Nëse ka mirëkuptim mund të shkohet në zgjedhje. Partitë në pushtet duhet ta kuptojnë se nuk mund të funksionojnë kështu. Nuk qeveriset me pakicë sepse një qeverisje e tillë nuk ka legjitimitet. Prandaj liderët politikë duhet të takohen dhe të bisedojnë gjatë, sepse për proceset e mëdha është i nevojshëm konsensusi. Dialogu me Serbinë nuk është çështje e një partie politike apo e një qeverie, por e gjithë spektrit politik. Ka hapësirë për arritjen e këtij konsensusi, por partitë në pushtet po përdorin injorancën.

"Epoka e re": *Mund të arrihet ky konsensus deri në shtator kur edhe është paralajmëruar takimi i radhës Thaçi - Vuçiq?*
Asllanaj: Duke e pasur parasysh situatën në të cilën gjendemi, është vështirë të arrihet ky konsensus, por nuk është e pamundur. Duhet të punohet shumë në këtë drejtim, pa pretenduar se LDK-ja do të zmbapset nga qëndrimet e veta.

Austria ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën gjatë Presidencës së BE-së

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri Dardan Gashi ka pritur në një takim ambasadorin e Republikës së Austrisë në Kosovë, Gernot Pfandler, të cilin e ka njoftuar për takimet në Bruksel javën e kaluar dhe për çështje të tjera që lidhen me marrëdhëniet mes dy shteteve. Republika e Austrisë, e cila mban presidencën e BE-së për gjashtë muajt e ardhshëm, pritet të jetë mbështetëse e Kosovës, si një vend mik, në proceset vendimmarrëse, nëpër të cilat vendi ynë do të kalojë. "E informova ambasadorin Pfandler për takimet në Bruksel, duke theksuar vendosmërinë e institucioneve për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe për përfshirjen e opozitës së Kosovës në këtë dialog. Njëkohësisht, duke pasur parasysh faktin se Austria



mban kryesimin e radhës të BE-së, shprehja bindjen që si shtet mik do ta mbështetë Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave dhe proceseve të tjera integruese", ka thënë zëvendëskryeministri Gashi. Ndërkaq ambasadori austriak, Gernot Pfandler, ka theksuar se Austria do t'i asistojë Kosovës në të gjitha proceset gjatë presidencës. Po ashtu,

ambasadori Pfandler ka premtuar angazhim për zgjidhjen e çështjes së kartonit të gjelbër për qytetarët e Kosovës dhe pjesëtarët e diasporës. Në takim u diskutua edhe për forcimin e marrëdhënieve ekonomike mes dy shteteve, veçanërisht për projektet investive që pritet të vijnë nga Austria në fushën e energjisë.



Prishtina, nga vjeshta, me kamera trafiku

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Nga vjeshta do të vihen në funksion kamera të trafikut për të dhënë dënime automatike. Kështu ka bërë me dije të martën kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti. "Në vjeshtë Komuna e Prishtinës do të fillojë me kamerat e trafikut dhe dënimet automatike. Dënimet do t'i mbledhim me

përmbarues dhe jemi përkrahës edhe të politikës që të mos lejohet regjistrimi i veturës me dënime të papaguara nga viti i kaluar", ka shkruar Ahmeti në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se numri i aksidenteve në Kosovë që një kohë është bërë shqetësues. "Shpejtësia e

pakontrolluar dhe mospërshtatja ndaj kushteve atmosferike janë shkaqet kryesore që shkruhen në raportet e aksidenteve. Por, duhet të flasim edhe për politikën publike në Kosovë në lidhje me sigurinë në trafik në vitet e fundit. Ka korrelacion të ngushtë në mes të dënimeve në trafik dhe numrit të aksidenteve,

por jo vetëm të shkrimit të dënimeve, por pagesave të dënimeve", ka theksuar ai. Ahmeti ka shtuar se as ligji i ri me rritjen e dënimeve nuk e ka efektin e duhur, për faktin se ndryshimi ndodhë te pagesa. "Rrallë ka polic që shkruan dënim 900 euro për shpejtësi. Thjesht, është shumë vështirë ta dënosh në

Kosovë dikë 900 euro. Ne kemi marrë letër edhe nga Avokati i Popullit se dokumentet nuk mund të merren si peng për pagesë të dënimeve, por në qoftë se nuk gjendet mënyrë e pagesës së shpejtë të dënimeve, shpejtësia dhe shkeljet në trafik do të jenë edhe më të shpeshta", është shprehur Ahmeti.



Përurohet hapësira e re në Spitalin e Vushtrrisë

VUSHTRRI, 24 KORRIK (ER) - Në spitalin e përgjithshëm të Vushtrrisë është përuar hapësira e re prej 400 metra katrorësh, me pesë dhoma shtesë për pacientë (15 shtretër), recepcioni, hapësira të nevojshme për mjekë e infermierë.

Sipërfaqja e ndërtuar ka krijuar hapësirë të mjaftueshme për repartin ekzistues të Kirurgjisë. Gjithashtu, janë krijuar mundësitë dhe pritet që të funksionalizohet edhe Reparti i Urologjisë. Me këtë rast ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka

thënë se qytetarët e Vushtrrisë tani nuk do të kenë më nevojë që për disa shërbime të shkojnë nëpër qytetet e tjera. "68 mijë banorët e Vushtrrisë deri më sot është dashur të udhëtojnë për në Prishtinë apo spitalet e tjera për shërbimet urologjike. Shpejt

ata nuk do të kenë nevojë ta bëjnë më këtë. Sot përuam investimin e ri në Spitalin e Përgjithshëm të këtij qyteti, me pesë dhoma shtesë, 15 shtretër më shumë, recepsion të ri, në një sipërfaqe prej 400 metrash katrorë, me ndihmën e

'Gjysmëhënës së Kuqe'', ka thënë ministri Ismaili. Ai ka shtuar se investimet e Ministrisë së Shëndetësisë nuk do të ndalen për Vushtrrinë dhe qytetet e tjera në Kosovë për t'i bërë spitalet edhe më moderne dhe të qasshme për pacientët.

Limaj falënderon bizneset e diasporës për promovimin e prodhimeve të Kosovës

Me rastin e hapjes së panairit me produkte vendore në kuadër të Ditëve të Diasporës, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se bizneset shqiptare të diasporës janë shtylla kryesore e promovimit të prodhimeve tona vendore në vendet perëndimore

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 24 KORRIK - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, të martën në Prishtinë është hapur panairi, tashmë tradicional, me punime dore, veshje kombëtare dhe ushqime tradicionale. Hapjen e panairit e bënë zëvendëskryeministri Fatmir

Limaj dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi. Me rastin e hapjes së panairit me produkte vendore në kuadër të Ditëve të Diasporës, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj u ka shprehur mirënjohje të jashtëzakonshme bizneseve shqiptare të diasporës.

Limaj ka thënë se bizneset shqiptare të diasporës janë



shtylla kryesore e promovimit të prodhimeve tona vendore në vendet perëndimore. "Falënderoj organizatorët. Si asnjëherë më parë, neve na është dhënë rasti t'i shohim prodhimet tona në vende të Evropës. Kjo është bërë në sajë të biznesit të diasporës me prodhimet vendore. Nuk ka familje në diasporë që nuk e ka një veshje kombëtare apo një

shenjë kombëtare", ka thënë zëvendëskryeministri Limaj. Ndërkaq ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka theksuar se ky panair është një ndër aktivitetet e shumta që Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka organizuar për bashkatdhetarët. Ai u shpreh se ministria që drejton çdoherë do t'i mbështesë aktivitetet e tilla si

ky panair, përmes të cilit ruhet identiteti kombëtar dhe tradita shqiptare. Në këtë panair me punimet e tyre po marrin pjesë më shumë se 70 prodhues e shoqata nga vendi dhe trevat e tjera shqiptare. Përmes këtij panairi, përmes punës së këtyre grave, bashkatdhetarëve do t'u prezantohet tradita shqiptare. Panairi do të qëndrojë i hapur deri më 27 korrik.

Policia themelon task forcë për parandalim të aksidenteve në trafik

Qëllimi kryesor i kësaj task force është që përmes komandës dhe kontrollit të ndikohet në parandalimin e aksidenteve të trafikut rrugor, duke angazhuar sa më shumë personel policor nga niveli qendror dhe ai lokal, duke përfshirë edhe stafin udhëheqës të policisë

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Policia e Kosovës, pas rritjes së numrit të madh të aksidenteve në ditët e fundit, ka themeluar task forcën për t'i parandaluar aksidentet në trafik. "Apelet, fushatat vetëdijësuese, veprimet operacionale policore, qasja e institucioneve të tjera relevante që kanë rol dhe ndikim në ndryshimin e kësaj gjendje në trafik, shfaq nevojën e krijimit të mekanizmeve shtesë për të kontribuar për një siguri edhe më të madhe nëpër rrugët tona. Dhe për këtë qëllim Policia e Kosovës nga sot ka themeluar task forcën për parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, qëllimi kryesor i kësaj task force është

që përmes komandës dhe kontrollit të ndikohet në parandalimin e aksidenteve të trafikut rrugor, duke angazhuar sa më shumë personel policor nga niveli qendror dhe ai lokal, duke përfshirë edhe stafin udhëheqës të policisë. Plani veprues dhe parandalues i kësaj task force parasheh përfshirjen, koordinimin dhe bashkërendimin e njësive të ndryshme në terren, në pika kontrolli, akse rrugore, si dhe aplikimin e metodave të ndryshme të avancuara nga njësitet policore, për arritjen e parandalimit të aksidenteve në tërësi, në veçanti të atyre me pasoja fatale. "Gjithashtu, për ta arritur dinamikën e ndikimit tek shoferët pjesëmarrës në trafik do të aplikohet 'zero tolerancë ndaj të gjithë



kundërvajtësve", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës. Për një efekt parandalues-pozitiv

të këtyre angazhimeve dhe masave operative të planifikuara, Policia e Kosovës kërkon tek të gjithë pjesëmarrësit në trafik,

posaçërisht te shoferët/drejtuesit e automjeteve, që t'i respektojnë rregullat që dalin nga Ligji i trafikut rrugor.



5 000 punëtorë të KEK-ut do t'i përdorin shërbimet më të reja të Valës

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues të KEK-ut, Njazi Thaçi, kanë nënshkruar të martën marrëveshje, me anë të së cilës afër 5 000 punëtorë të KEK-ut, përfshirë edhe menaxhmentin, do t'i kenë në telefonat e tyre shërbimet më të reja të Valës dhe do të përfitojnë nga rrjeti i shpejtë i internetit 4G

Thaçi. Me anë të kësaj marrëveshje afër 5 000 punëtorë të KEK-ut, përfshirë edhe menaxhmentin, do të kenë në telefonat e tyre shërbimet më të reja të Valës dhe do të përfitojnë nga rrjeti i shpejtë i internet 4G, që kësaj korporate do t'ua lehtësojë në masë të madhe sistemin e operimeve teknologjike.

Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli, ka bërë me dije se është tejet i entuziazmuar për nënshkrimin e kontratës me KEK-un duke thelluar edhe më tepër këtë partneritet reciprok. "Të gëzon fakti se edhe një ndërmarrje e madhe me mijëra punëtorë, siç është KEK-u, i

bashkohet Valës, gjë që përbën një kënaqësi dhe obligim për ne që produktet dhe rrjetin tonë t'i pasurojmë dhe forcojmë edhe më tutje në dobi të të gjithë atyre që i besojnë operatorit publik, Valës dhe shërbimeve të saj", ka deklaruar Begolli.

Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues të KEK-ut, Njazi Thaçi, ka thënë se nënshkrimi i kontratës mes këtyre dy ndërmarrjeve paraqet një bashkëpunim dhe mirëbesim të vazhdueshëm mes dy gjigantëve të ekonomisë së Kosovës. "Është e rëndësishme të thuhet se jemi shumë të kënaqur me shërbimet e Valës dhe kjo marrëveshje e sotme është një tjetër dimension

i thellimit të bashkëpunimit mes dy kompanive, në vazhdim të bashkëpunimeve që kemi pasur edhe në të kaluarën. KEK-u është korporata më e madhe në vend edhe nga aspekti kapital, edhe me numrin më të madh të punëtorëve, andaj më afër 5 000 punëtorë do të jemi pjesë e shfrytëzimit të shërbimeve të Valës për shkak të ofertës së saj më të favorshme", ka theksuar Thaçi.

Telekomi i Kosovës së fundi ka hedhur në treg oferta të ndryshme dhe shumë konkurruese për të gjithë konsumatorët duke mundësuar pako të shumëllojshme me biseda pa limit dhe internetin më të shpejtë.

EPOKA E RE **Albulena S, MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 KORRIK - Ndërmarrja më e madhe energjetike në vend, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), i është bashkuar valës së kalimeve masive të institucioneve shtetërore, kompanive publike,

bizneseve private, universiteteve dhe qytetarëve, në operatorin me ofertat më joshëse në treg, Vala. Kjo është bërë e mundur pas nënshkrimit të marrëveshjes nga kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Gent Begolli dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit menaxhues të KEK-ut, Njazi

ATK-ja për gjashtë muaj ka realizuar 43 mijë aktivitete

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Shërbime profesionale, efikase dhe transparente për tatimpaguesit janë prioritetet e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Sipas një njoftimi të ATK-së, Qendra për Shërbim të Tatimpaguesve funksionon në të gjitha drejtoritë rajonale të këtij institucioni, e cila brenda strukturës së vet përbëhet nga tri njësi organizative, atë të shërbimeve të drejtpërdrejta për tatimpaguesit, këshilltarëve tatimorë, si dhe zyrtarët e kontributeve pensionale. Qëllimi dhe fushëveprimi i

Divizionit të Shërbimit të Tatimpaguesve është krijimi dhe menaxhimi i politikave, si dhe strategjive për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative, në kohë dhe me saktësi për tatimpaguesit. Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesve në Prishtinë vetëm gjatë periudhës janar-qershor 2018 ka realizuar 43 664 aktivitete, përfshirë këtu kërkesa për numër fiskal, regjistrim në TVSh, kërkesa për regjistrim në TAP dhe TAK, kërkesa për vërtetime tatimore, kërkesa për pajisje fiskale, kërkesa për marrëveshje për pagesë,



këshilla ligjore etj. "Po gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe seminare për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në gjashtë komuna të rajonit të Prishtinës, me ç'rast janë mbajtur 12 seminare me nxënës të shkollave fillore dhe 12 seminare me nxënës të shkollave të mesme. ATK-ja në vazhdimësi është e përkushtuar t'i përmirësojë shërbimet ndaj tatimpaguesve në mënyrë që t'ua bëjë më të lehtë deklarinimin dhe pagesën e tatimeve", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Importi rritet për 20 për qind në krahasim me vitin e kaluar

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 KORRIK - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin qershor 2018. Të dhënat nga Tregtia e Jashtme në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 23.5 për qind në muajin qershor 2018, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2017, gjegjësisht në vlerë prej 268.5 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 217.4 milionë eurosh në vitin 2017. Eksporti mbulon importin me 12.1 për qind.

Eksporti i mallrave në muajin qershor 2018 kishte vlerën 37.1 milionë euro, ndërsa importi 305.7 milionë euro, që është një rënie

prej (-2.8 përqindësh) për eksport dhe një rritje prej 19.6 përqindësh për import, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 27.8 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 25.9 për qind e përbëjnë produktet minerale; 10.3 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7.9 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.4 për qind e përbëjnë produktet bimore; 4.1 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 3.4 për qind e përbëjnë lëkura dhe artikujt prej saj; 2.6 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 16 për

qind të importit e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 13 për qind e përbëjnë produktet minerale; 12.1 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.7 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 7.5 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 6.7 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.5 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 4.4 për qind e përbëjnë produktet bimore etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 13.3 milionë euro, ose rreth 35.9 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 15.5 përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Sllovenia (9.9 për qind), Gjermania (5.6 për qind), Holanda (4.2 për qind),

Britania e Madhe (3.4 për qind), Italia (2.6 për qind).

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 140.2 milionë euro, ose 45.9 për qind e importeve të përgjithshme, një rritje prej 28.2 përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (15.4 për qind), Italia (7.1 për qind), Greqia (3.6 për qind), Spanja (3.5 për qind), Polonia (2.5 për qind) etj.

Në muajin qershor 2018 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 17.4 milionë euro, ose 47.1 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej -7.6 përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s janë: Shqipëria (14.4 për qind), Serbia (13.4 për qind), Maqedonia (11.8 për qind), Mali i Zi (5.2 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin qershor 2018 arritën në 80.8 milionë euro, ose 26.4 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej -12.8 përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (12.3 për qind), Shqipëria (6.7 për qind), Maqedonia (4.8 për qind) dhe B & H (2.1 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 6.3 milionë euro, ose 17 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmendet Zvicra me 10.1 për qind.

Ndërkaq importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 84.6 milionë euro, ose 27.7 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (10 për qind) dhe Kina (8.7 për qind).



AZhB-ja merr vendim për shlyerjen e njërit numër identifikues të fermës (NIF)

Të gjithë ata fermerë që kanë aplikuar për të përfituar grante investive në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të vitit 2018, obligohen që brenda afatit të përcaktuar ligjor prej tetë ditësh të deklarojnë në mënyrë vullnetare në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për shlyerjen e njërit Numër Identifikues të Fermës nga ekonomia e tyre familjare

PRISHTINË, 24 KORRIK (ER) - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka marrë vendim për shlyerjen e njërit numër identifikues të fermës (NIF) nga ekonomitë familjare,

të cilat kanë më shumë se një numër të tillë.

Të gjithë ata fermerë që kanë aplikuar për të përfituar grante investive në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të vitit 2018, obligohen që brenda afatit të përcaktuar ligjor prej tetë ditësh të deklarojnë në mënyrë



vullnetare në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për shlyerjen e njërit Numër Identifikues

të Fermës nga ekonomia e tyre familjare.

Ky vendim e obligon Drejtorinë e

Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural në AZhB, që gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për programet për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2018, në të cilat gjatë vlerësimit konstatohet nëse një ekonomi familjare ka më shumë se një numër identifikues të fermave, të njoftohen menjëherë aplikuesit për shlyerjen e njërit numër.

Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të AZhB-së, Ekrem Gjokaj, ka treguar se ky vendim është marrë duke u bazuar në praktikat më të mira bujqësore si dhe pas ankesave të disa fermerëve për mosdiskriminim.

A DO TË BËHET AGIM BAHTIRI SI ISA BOLETINI PASI RAMIZ KELMENDI NUK U BË SI ÇERÇIZ TOPULLI



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Trimat e Kosovës dhe dilberët e Jakovës: Kosova gjithmonë ka pasur trima dhe patriotë që, kur e ka kërkuar trualli, nuk kanë kursyer asgjë, që nga pasuria e deri te ajo që nuk paguhet me para, por që të siguron hyrje në Panteonin e Lavdisë dhe të Nderit dhe të bën të pavdekshëm duke ua siguruar përjetësinë - jeta. Shqiptarët kanë reaguar vendosmërisht kur është prekur kufiri, ai shtetëror, sidomos ai rreth ushkurit. Kur flitej për kufirin me Malin e Zi dhe kur kundërshtimi ishte thuaja i përgjithshëm, një person më pati bërë shumë përshtypje me vendosmërinë e tij dhe gatishmërinë për t'u sakrifikuar, deri në plazma keksin e fundit, deputeti aktual i LDK-së dhe deputet i mëhershëm i AAK-së dhe PDK-së, Ramiz Kelmendi.

Ai e kundërshtonte vendosmërisht demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, edhe nga aspekti parimor apo i atdhedashurisë për të cilën ka prova monumentale si dhe nga aspekti i përfaqësimit të interesave rajonale, në rastin konkret të Dukagjinit sepse është i atij rajoni dhe ishte betuar para anasve se do t'i përfaqësonte dhe mbronte interesat e tyre deri në fund. Si naiv që jam, pata filluar ta parafytyroj Ramizin të veshur në veshje të Rugovës, me tirq dhe xhamadan dhe me atë shaminë e bardhë rreth plisit që rugovasi e përdornin si qefinë për faktin se vdekjen e kishin më të afërt se këmishën shkaku se kurrë nuk e kishin ndalur luftën kundër dhunuesve të lirisë së shqiptarëve dhe grabitësve të tokave shqiptare. Kështu, pas qëndrimit të Ramiz Kelmendit kundër demarkacionit e shihja të veshur me tesha kombëtare, me rrethatore me fishekë, jatagan në brez dhe rekuizitat e tjera përcjellëse që do

ta kompletin figurën dhe personalitetin e një luftëtari të shquar rugovas. Në tërë këtë ikonografi disi nuk më flinte figura e Ramizit i veshur me tirq shkaku se estetikisht më dukej jashtë realiteti për faktin se, për shkak të humbjes së linjave trupore, tirqit nuk i shkonin në përputhje me trimërinë e dëshmuar. Mendoja ta gjeja një veshje alternative, por që nuk e cenon burrërinë, vendosmërinë dhe trimërinë e Ramizit dhe që është në përputhje të plotë me traditat kombëtare. Sa i përket trimërisë, vendosmërisë dhe patriotizmit, vlerësimi im ishte se Ramizi nuk mbetej aspak prapa Çerçiz dhe Bajo Topullit, Mihal Gramenos apo trimave dhe patriotëve të Sulit. Në anën tjetër, të gjithë këta trima kishin të veshur fustanellën e cila jo që nuk i zhburrëronte, por ua krijonte një identitet që ka mbetur i respektuar edhe sot. Sa mendova se Ramizi me fustanellë do të sillte një ndryshim dhe freski në skenën politike dhe patriotike të Kosovës e që do të radhitej pas Çerçiz dhe Bajo Topullit, Mihal Gramenos dhe trimave të Sulit, personazhi im i hapi këmbët dhe e votoi demarkacionin. Disi u bë si Ali Pashë Tepelena, me fustanellë si ai, me trimëri as për së afërmi, kurse me mashtrim bukur i ngjante. Tash, nga prospekti i ditëve tona, edhe fustanella e Ramizit do të kryente punë! Së paku më lehtë do t'i hapte këmbët!

Agim Bahtiri ishte dhe mbeti patrioti i radhës. E la Holandën e luleve dhe të lopëve për të kontribuar për konsolidimin e paqes dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Për këtë, si kornizë dhe përmbajtje për veprim politik e zgjodhi partinë më kombëtare në Kosovë, Aleancën Kosova e Re, e udhëhequr nga patrioti i dëshmuar dhe pranuar, sidomos ndërkombëtarisht, kurse padrejtësisht i kontestuar në Kosovë, Behgjet Pacolli. Agim Bahtiri në planin politik dhe intelektual thuaja se është Hasan Prishtina i ditëve tona (ashtu e ka cilësuar edhe Albin Kurti), kurse në planin ushtarak, luftarak dhe të trimërisë është kopje thuaja origjinale e Isa Boletinit. Po të

mos i kishte këto dy veti, dijen dhe guximin, do të bëhej deputet apo ministër e jo kryetar i një komune shumë problematike siç është Mitrovica. Trimat dhe të mençurit i kërkon vendi, koha dhe gjaku dhe, Agim Bahtiri nuk bëhej tjetër veç përmbajtjes që e ka dhe e cila ia kushtëzon veprimin politik, patriotik dhe strategjik. Kur të gjithë bënin hajgare me Agimin, ai i fshiu të gjithë kandidatët kundërshtarë dhe u bë i Pari i Mitrovicës të cilën e ndante me Goran Rakiqin që Mitrovicën e veriut e kishte zaptuar krejtësisht. Gjatë mandatit të parë të Agimit u betonua ndarja e Mitrovicës, me mure, me tela me gjemba, me paramilitarë, me kriminelë dhe kategori të tjera kushtetuese të kriminelit kushtetues dhe juridik, Mati Ahtisarit. Sa më shumë që ndahej Mitrovica (edhe Kosova) Agimi thoshte se Mitrovica (edhe Kosova) po bashkohet! Në bisedimet me Rakiqin (Vuçiqin) nuk flitej më për ndarjen e Mitrovicës, por bëhej luftë për territor të fshatrave përreth, për metra dhe centimetra të këtyre territoreve. Agimi kandidoi edhe për mandatin e dytë për kryetar të Mitrovicës. Kurrë nuk pata besuar se ka gjasa, qoftë edhe minimale, për të fituar dhe më dukej komike për vetë faktin se kandidoi. Natyrisht kështu nuk mendonin Agimi dhe Nexhmedin Spahiu i cili, me siguri fliste për fitoren e Agimit në kohën kur Agimi as që e vinte në dyshim këtë fitore. Dhe doli të jetë i saktë parashikimi i Agimit dhe Nexhit kurse, unë, si "parashikues", ia futa, si kau - pelës! Pasi e fitoi edhe një mandat, Agim Bahtiri u bë i afërt me Rakiqin me të cilin takoheshin Te Ura sikur që shkonte shpesh në Bruksel për bisedimet teknike. Këto takime, Te Ura, u ngjanin takimeve midis Floberit dhe madame Bovarisë, pa i përcaktuar rolet kush është Floberi e kush medame Bovari. Në planin intelektual i takon Agimit të jetë Floberi... gjithsesi. Ata që e ndanë Mitrovicën në Rambuje (burokratët e Brukselit dhe injorantët kosovarë), e përligjën këtë ndarje sidomos pas përfundimit të luftës. Është si rregull që në të gjitha vendet ku ka pasur konflikte të armatosura,

një pjesë e territorit apo një qytet ndahet në mënyrë që të përdoret pastaj gjatë bisedimeve për vendosje të paqes apo disiplinim të atyre që nuk binden. U nda Gjermania pas Luftës së Dytë Botërore, iu morën disa ishuj Japonisë, u dëmtua Italia, u nda Mostari, Brčko dhe Vukovari, por të gjitha u zgjodhën me kalimin e kohës. Se ndahet një qytet apo një territor dhe se kjo ndarje legjitimohet disa vjet pas përfundimit të luftës, rast të ngjashëm nuk ka në botë sikur që është rasti i Mitrovicës. Në të gjitha rastet e marrjes së përkohshme të territoreve apo ndarjes së përkohshme është bërë ndaj shteteve dhe vendeve që e kanë humbur luftën kurse, në Kosovë, ndodh e kundërta: shteti që ka shkaktuar luftën dhe që e ka humbur luftën shpërblehet për krimet e bëra, kurse vendi (tash shteti - Kosova) që e ka pësuar po dëmtohet padrejtësisht. Janë të freskëta skenat ku Agimi para medie elektronike dhe të shkruara deklaronte se në muajin tjetër do të hapet ura dhe se Mitrovica po bashkohet kurse, në të vërtetë, ajo ndarje bëhej e pakthyeshme. Gjithashtu, thoshte se është në linjë të përditshme me kryetarin Rakiq duke e krijuar një paralele të komunikimit, si për kah pesha, ashtu edhe për nga rëndësia me komunikimin Putin - Trump. Tash kur Asociacioni i Serbisë në Kosovë po përligjet duke u bërë kategori kushtetuese dhe kur hapësira biznesore dhe jetësore e Agimit dhe shefit të tij (Gjet Collit) po ngushtohet dhe se kur edhe budallenjtë me letra po e kuptojnë qëllimin e Serbisë, Agim Bahtiri po e mbledh Kuvendin e "burrave" për t'iu treguar se Kosova po rrezikohet dhe mund të ndahet. Nga sallat komode të Mitrovicës së Jugut, Agim Bahtiri, fermer nga Holanda dhe politikan në Kosovë, po i kërcënohet edhe shefit të Madh në Prishtinë (Gjetit të Pacollëve) sikur edhe Hashim Blerimbekimit (treshi banditesk) se, nëse ndodh ajo që veç ka ndodhur, atje do të ketë luftë dhe se, sa të jetë gjallë Agim Bahtiri dhe sa të ekzistojë Mitrovica nuk do të ketë ndarje e as këmbim territorësh!!! Fjalë burrash dhe

kërcënimit të trimave të viagrës patriotike dhe kombëtare. Sytë m'u mbushën me lot, ajo gjysmë zemre që më ka mbetur punonte si e çmendur dhe ia krisa këngës shumë patriotike dhe frymëzuese: "... jo nuk ndahet o Mitrovica ...". Kurrë nuk kam pushuar të luftoj për bashkim me Mitrovicën dhe kurrë nuk jam dorëzuar apo ligështuar në këtë drejtim. Prejardhjen e kam nga ajo anë, nga fshati Kovaçicë e Shalës së Bajgores andaj kam motiv shtesë që ta përkrah Agim Bahtirin e sidomos Shkurte Fejzën. E pranoj se Agimi mund të paraqesë rrezik për mjedisin, sidomos pordhët e tij politike dhe patriotike, kurse nga Shkurte Fejza nuk ka ndonjë rrezik, nëse je në disponim për të dëgjuar tallava muzikë e lëshon këngën e saj se: "Kurrë nuk ndahet o Mitrovica", në të kundërtën e dëgjon muzikën e mirëfilltë korçare apo polifoninë e jugut të mëmëdheut.

Alkimistët e dikurshëm dhe alkimistët e ditëve tona: Alkimistët e dikurshëm tërë kohën e kalonin në kërkim të Gurit Filozofik dhe bënin përpjekje të pareshtur që, me metoda alkimiste, metalin ta shndërronin në ar e që kurrë nuk ia arritën këtij qëllimi. Alkimistët e sotëm, si injorantë që janë, kurrë nuk bëjnë përpjekje ta gjejnë Gurin Filozofik, por si ta fitojnë ndonjë tender milionësh apo të privatizojnë pasuri dhjetëra e qindra milionë eurosh me pak para ose fare pa para. Këta alkimistë modernë në Kosovë ia kanë arritur këtij qëllimi për dallim prej alkimistëve të dikurshëm. Alkimistët e sotëm, në vend të Gurit Filozofik, bëjnë garë se cilin budalla do ta instalojnë, me metoda mafioze-alkimike, në majat e pushtetit. Alkimistët e sotëm, e që do t'i veçoja dy më kryesorët, Hashimin dhe Behgjetin, ia kanë arritur plotësisht këtij synimi që budallenjtë t'i vendosin në maja të pushtetit. E kanë një dështim në përpjekjet alkimike që m...in ta bëjnë mjalte. Edhe këtu janë ekzemplarë për faktin se çdo gjë që e kanë prekur me dorë e që kanë menduar ta bëjnë mjalte, e kanë bërë krejt m...! Në mesin e

arritjeve kapitale alkimike të Hashimit dhe Behgjetit, janë edhe dy shembujt e përshkruar më lart, i "Isa Boletinit" dhe "Çerçiz Topullit". Në akademinë e alkimizmit në Kosovë, rektor është Hashim Thaçi, kurse dekan është Behgjet Pacolli. Sipas përgjegjesisë së hierarkisë, Hashimi është njëshi (1) i alkimisë sepse vetëm ai, me metoda alkimike, deri më tani të panjohura e ka bërë të ndihet gjallë një kufomë politike dhe kombëtare siç ishte Gjet Colli dhe i cili sot po shndërrohet në kallauz të çështjes politike dhe kombëtare në Kosovë. Merreni me mend, sa larg ka shkuar dhe përparuar alkimia në Kosovë! Pastaj, Hashimi po e interpreton së prapthi alkimin, në vend se nga m..i të bëjë mjalhtë, ai me metodat të prapta alkimike, nga mjalti po e bënë m...t, çdo gjë që ta prekë me dorë...!

Dilberat e Jakovës, në mungesë të trimave të Kosovës: Shumë të tillë që dikur konsideroheshin trima të Kosovës sot janë shndërruar në dylbera të Jakovës, i kanë lëshuar brekët në Bruksel dhe po ua përmbushin kërkesat perverse të burokratëve të Brukselit dhe duke bërë llogari krejtësisht të gabuara se, duke ua kthyer prapanicën, me brekë të lëshuara, do ta shpëtojnë kokën. Kjo kurrë nuk ka ndodhur më parë dhe është treguar si qasje e gabuar edhe në rast se për këtë ka pasur nevoja fiziologjike. Shumë moti, në Besianë (Podujevë), njëri ka pasur të meta të lindura në fytyrë dhe ka pasur nevojë ta bëjë operim të lëkurës së fytyrës, duke e ndërruar një pjesë të saj. Për shkak të ikjes së komplikimeve post-operative dhe që për shkak të mundësisë së refuzimit të lëkurës së huaj të një dhuruesi të mundshëm, kirurgu plastik pati vendosur që, një pjesë të lëkurës së prapanicës së personit që duhet të operohet do të vendosej në fytyrën e të pafatit që operohet. U bë si u bë operacioni dhe i operuari shkoi te Fazli Llughaliu, i njohur për hajgare dhe e pyeti se si dukej me pamjen e tij të re pas operacionit. Fazliu, për të mos e ofenduar të operuarin, i thotë se po dukej shumë më mirë dhe se në aspektin strategjik është rast unik në Kosovë, duke u lavdëruar se ish-personi i vetëm në Kosovë

që, edhe bythën edhe fytyrën e kishte në një vend. A po përsëritet kjo histori edhe sot në Kosovë?!

Ngacmimet seksuale dhe bisedimet e Brukselit: Raportimi për ngacmime seksuale sot është bërë modë hollivudiane. Atje me një vonesë edhe deri në 30 vjet artiste dhe këngëtare që kanë bërë famë po i akuzojnë për ngacmime dhe dhunime seksuale ata që iu ndihmuan të bëjnë karrierë. Pasi fama e tyre iku së bashku me moshën, po riciklohen si figura publike duke denoncuar, me të drejtë dhe të padrejtë, ish-promotorët e tyre. U akuzua dhe u detronizua regjisorin dhe producentin Venstajn, komiku Bill Krozbi dhe figura të njohura të shoubizit botëror. Edhe të ne ka denoncime për ngacmime seksuale. Është bërë vështirë të tërheqësh një vijë ndarëse midis një komplimenti dhe ngacmimit seksual të supozuar. Është bërë problem, bukur problem sepse, edhe nëse i "turresh" gruas apo partneres gjatë kohëzgjatjes së një seriali turk, mund të akuzohesh për ngacmim seksual apo, mbase, edhe për një dhunim. Madje, mos u befasoni që, pas përfundimeve të bisedimeve politike në Bruksel, Katrin Eshton apo përkthyesja e Ivica Daçiçit ta akuzojë Hashim Thaçin për ngacmime seksuale sikur edhe Frederika Mogerini të akuzojë për ngacmime seksuale, edhe Isa Mustafën, edhe Hashim Thaçin. Apo edhe këtë grupin e burrave që u takuan së fundi me Frederikën në Bruksel. Për më keq e që na prekë në sedrën e burrërisë dhe nderit, z. Kuper mund ta akuzojë njërin nga t/kryeministrat e Kosovës për ngacmime seksuale apo, së paku dy prej tyre. Definitivisht, keq po ndahemi në këto bisedime, edhe politikisht, edhe seksualisht!

Fituesit realë të bisedimeve të Brukselit: Janë vetëm dy fitues të këtyre bisedimeve në Bruksel në përpjekje për të ndërtuar një konsensus kombëtar dhe politik: 1. Është Naim Rashiti që po mbanë tryeza impotente seriale dhe, 2. Behgjet Pacolli që po ua mbushë cullën pjesëmarrësve në këto tryeza të kota ku nuk ka asnjë rezultat përveçse planifikohet tryeza e radhës impotente

nga persona të tredhur nga çdo përgjegjësi njerëzore, kombëtare, morale dhe politike. Kur nuk të dëgjojnë, merre botën para: Kadrinë nuk po e dëgjojnë jo vetëm këta të opozitës, por as edhe të partisë që po e udhëheq së bashku me Hashimin. I thirrë në një takim, por nuk i erdhën. Pasi u bë tym dhe flakë, e mori botën para dhe drejt e në Romë. Për të lobuar për viza. E ka ekipin e fortë me vete dhe nuk ka si të dështojë. Vizat me kësmet do të bëhen, nëse jo në këtë vit, atëherë e kemi vitin 2019. Pastaj, bota e as liberalizimi i vizave nuk përfundon në vitin 2019 sepse pastaj vjen viti 2020 e kështu me radhë. Vetëm në Shqipëri dhe Kosovë kam parë që opozita u gëzohet dështimeve edhe në rast se janë kundër interesave të qytetarëve dhe shtetit. Në Shqipëri, Lul Taraba dhe Sali Pacienti po gëzohen se Shqipëria nuk e ka filluar këtë vit fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE. Rast për mjekësi, për psikologë dhe për psikiatri. Në Kosovë po i gëzohen fillimit të punës së Gjykatës Speciale dhe arrestimit të gjithë atyre që kanë luftuar kundër Serbisë sepse në këtë mënyrë po shpresojnë se e marrin pushtetin. Avdullah Hoti, si një nga zgjatimet e kokës së meduzës së lënduar të quajtur LDK (tash janë së paku 10 zgjatime që duan të bëhen Isa Mustafë) po këmbëngul në zgjedhje të reja që nuk do të ndodhin, së paku edhe një vit. E di Dulla dhe e dinë të tjerët se nuk ka zgjedhje dhe se këta nuk vendosin për zgjedhje, por e lëshon gjithmonë të njëjtën pllakë të gramafonit të prishur. Albini, si në përrallat e 1001 netëve, kërkon të bëhen analizat për rezultatet e bisedimeve të deritashme dhe, pas vlerësimeve pozitive (sigurisht të Albinit), do të vlerësohet nëse dhe kurrë do të vazhdohet me bisedime të tjera. Me këto përralla Albini po e vendos veten në epiqendrën e zhvillimeve botërore ndonëse nuk e pyet askush për hijgje. Askush nuk është i interesuar për zgjedhje, askush nuk i don zgjedhjet, prandaj të gjithë duan të shkojnë në zgjedhje!!! Hajt bacë (jo Behgjet Pacolli që u bë Baca i politikanëve të Kosovës), hajt! Rreni, rreni, asgjë nuk kushton dhe për rrena nuk paguani tatim!



Skenderaj shtron sofrën drenicase për mërgimtarë

SKENDERAJ, 24 KORRIK (ER) - Në Sheshin "Adem Jashari" është mbajtur aktiviteti "Sofra drenicase", në të cilin ka marrë pjesë edhe kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari. Ky aktivitet është ndjekur nga shumë qytetarë të të gjitha

moshave. Sofra drenicase është shoqëruar me interpretime të këngëve të muzikës tradicionale rapsodike nga anëtarët e Ansamblit "Drenica" me veshje kombëtare. Sofra drenicase është shtruar për diasporën.



Lladrovci fton bashkatdhetarët në takim

DRENAS, 24 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka ftuar të gjithë bashkatdhetarët në takim për të bashkëbiseduar për proceset e përbashkëta. Takimi do të mbahet më 2 gusht, duke filluar nga ora 14:00, në restaurant "Dijamant", Drenas. Nga 9 korriku, Komuna e Drenasit ka

nisur aktivitetet për muajin e mërgatës, event ky që mbahet nën përkujdesjen e kryetarit Lladrovci dhe do të zgjasë 28 ditë me aktivitete të ndryshme kulturore në Sheshin "Fehmi Lladrovci" për nder të bashkatdhetarëve që të kalojnë sa më mirë në vendlindjen e tyre gjatë pushimeve verore së bashku me familje.



50 mijë euro investime në "Kompleksin Rexhep Malaj"

KAMENICË, 24 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të martën në takim kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati. Në këtë takim ministri Gashi me kryetarin Kastrati kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimin për mbështetje financiare për projektin "Kompleksi Rexhep Malaj" në fshatin Hogosht.

Memorandumi do të zbatohet gjatë vitit 2018, projekt për të cilin MKRS-ja do të investojë 50 mijë euro. Ministri Gashi ka thënë se këto investime po bëhen me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore. "Si MKRS zotohemi se do të angazhohemi maksimalisht që të investojmë në fushën e kulturës dhe të trashëgimisë". Ndërkaq kryetari i Komunës

së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka shprehur falënderim të veçantë për ministrin për përkushtimin e vazhdueshëm në sektorin e kulturës, rinisë, sportit dhe trashëgimisë për qytetarët e Kamenicës dhe jo vetëm.

EKREM BARDHA, SHQIPTARO-AMERIKANI QË LOBOI AQ SHUMË PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS

Bill Clintoni ia dha fjalën Ekrem Bardhë

- Shqiptari që takoi gjashtë presidentë amerikanë, sekretarë shteti, senatorë, kongresmenë, ambasadorë... U arratis nga Shqipëria, por kurrë dheun, vendin e vet, nuk e tradhtoi. Kosova ishte zemra e tij.



Shkruan: Ferdinand SAMARXHI,
Fitues i Antenës së Artë Mjeshtër i Madh

Vazhdon përgjigja e pyetjes: Çfarë ishte NAAC-u? Përse e themeluat ju?

Ekrem Bardha: Kështu i propozova ambasadorit Ryerson që të ishte ai kryetari i lobiit shqiptaro-amerikan, në ndihmë të çështjes kosovare, mirëpo ai nuk pranoi. Ai tha se kryetari i këtij lobi duhej të ishte një shqiptar, ndërsa më premti se ndihma e tij do të ishte e pakursyer. Kështu ndodhi, ambasadori Ryerson e mbështeti me të gjitha mundësitë e tij këtë nismë dhe luajti rol të madh në krijimin e Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan. Për krijimin e kësaj organizate shkova në Nju Jork dhe bisedova me Gary Kokalarin, Bruno Selimajn, Harry Bajraktarin, Sejdi Biticin, Dino Erbelin, vëllezërit Fundo, Sami Repishtin dhe në vitin 1996 krijuam Këshillin Shqiptaro-Amerikan (NAAC). Vlen të përmendet që NAAC-i ishte një organizatë vullnetare dhe mbetet në historinë e diasporës së Amerikës si këshilli më i njohur për veprimtarinë e tij në mbështetje të kauzave shqiptare dhe që zhvilloi në vitet që do të pasonin, një punë të çmuar me takime, udhëtime, mbledhje, demonstrata paqësore në mbështetje të çështjes kosovare. Gjatë angazhimeve shumëvjeçare ky këshill pati veprimtari të ngjeshur. Gjatë luftës së Kosovës spikati takimi i një përfaqësie të NAAC-ut me presidentin amerikan Bill Clinton, takimi me zëvendëspresidentin Al Gor, Zonjën e Parë, Hillari Clinton, ambasadorin Richard Holbrook dhe këshilltarin për Sigurinë Kombëtare, Sandy Berger. Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur takime të rregullta me Departamentin e Shtetit dhe anëtarë të Kongresit. Takimi me delegacionet gjatë bisedimeve në Rambuje, apo asistimi si vëzhgues në zgjedhjet e para në Kosovë pas luftës, ishin disa prej angazhimeve të Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan.

Në fillimet e para të UÇK-së, Uashingtoni kishte një mendim të gabuar, që UÇK-ja ishte një organizatë terroriste. Si ndikoi NAAC-ja në ndryshimin e këtij mendimi?

Ekrem Bardha: Aktiviteti ushtarak i UÇK-së rritej dita-ditës, ndërsa qendra e saj ishte lugina e Drenicës, zonë që kontrollohej nga komandanti i saj Adem Jashari. Disa ditë pasi Robert Gelbard e quajti UÇK-në grup terrorist, policia serbe sulmoi UÇK-në në zonën e Likoshanit dhe ndoqën disa prej luftëtarëve deri në Qirez, duke vrarë 16 luftëtarë shqiptarë, por mbetën të vrarë dhe katër policë serbë. Policia serbe ndoqi komandantin e parë të UÇK-së, Adem Jasharin, dhe bashkëluftëtarët e tij deri në fshatin Prekaz i Poshtëm. Pas një lufte të ashpër treditore, ku ushtria jugosllave përdori mjete të blinduara dhe artileri mbi shtëpinë e Adem Jasharit, mbetën të vrarë 56 anëtarë të familjes Jashari, nga të cilët 15 ishin gra dhe 10 fëmijë. Masakra e 5 marsit 1998 shkaktoi rritim të thellë në kryeqytetet perëndimore. Sekretarja e Shtetit, Madeleine Albright tha se tashmë "kjo krizë nuk është një çështje e brendshme e Republikës Federative të Jugosllavisë". Në këtë situatë, Këshilli Shqiptaro-Amerikan, organizoi një takim në Departamentin Amerikan të Shtetit, me zëvendësministrin e



Fotografi nga takimi i Ekrem Bardhës me Madeleine Albrightin dhe Hillary Clintonin

Jashtëm, ambasador Robert Gelbard. Në atë takim morën pjesë drejtori i NAAC-ut, Ilir Zherka, Gary Kokalari, Dino Erbeli dhe Lou Fundos. Arsyeja e këtij takimi ishte situata e rënduar në Kosovë dhe shqetësimi që ishte krijuar nga disa deklarata negative për luftëtarët e UÇK-së. Unë kisha mbetur i habitur dhe njëkohësisht i shqetësuar për deklaratën e ambasadorit Gelbard se "ushtarët e UÇK-së janë terroristë". Gelbard na priti në zyrën e tij dhe nisi të na fliste për atë që po bënte administrata amerikane për çështjen e Kosovës. Papritur, Gelbard nxori nga sirtari i tavolinës së tij emblemën e UÇK-së dhe ishte hera e parë që unë e shihja atë emblemë. "E dini ju se çfarë janë këta të UÇK-së?! Këta janë terroristë!", tha Gelbard, prerë dhe me ton të lartë. Në atë moment më zuri gjaku i shqiptarit, nuk e përmbajta dot veten dhe iu ktheva me një gjuhë të drejtpërdrejtë dhe aspak

diplomatike. I thashë: "Shame on you! (Turp të kesh!) UÇK-ja nuk është terroriste, por ata djem dhe vajza luftojnë kundër një gjenocidi të pashembullt në qendër të Evropës dhe për të drejtat e tyre njerëzore". Ambasadori nuk e priste një reagim të tillë. U befasua. U pa qartë një tronditje e tij nga reagimi im. Pas meje folën edhe Gary Kokalari, i cili edhe ai pati një reagim të ashpër ndaj kësaj deklarate të Gelbard. Në zyrën e Departamentit të Shtetit u krijua një gjendje e ndjerë dhe aspak miqësore. Pas këtij takimi, Gelbart u largua nga detyra që mbante, ndërsa Departamenti i Shtetit filloi të pranojë UÇK-në, jo më si organizatë terroriste. Kjo ka qenë një këmbëngulje e Këshillit Shqiptaro-Amerikan. Jam i sigurt se nëse nuk do të kishte qenë ky reagim i ashpër yni, jo vetëm në atë takim, por në vijim, duke dënuar këtë qëndrim ndaj luftës heroike të UÇK-së

për një kauzë të drejtë, çështja e Kosovës mund të ishte "groposur". Interesi i Amerikës ndaj saj nuk do të kishte qenë aq i fortë dhe vendimtar për shkak të qëndrimeve të zyrtarëve të tillë si Gelbard.

Ambasadori Richard Holbrooke së bashku me Gelbart dhe ambasadorin Christopher Hill shkuan në zonën e nxehtë të Kosovës, në Drenicë, takuan dy drejtues lokalë të UÇK-së, njëri jurist dhe tjetri gazetar. Një ditë më vonë, Departamenti i Shtetit deklaroi përmes zëdhënësit James Rubin, se amerikanët as nuk e kishin konsideruar dhe as e konsideronin UÇK-në si terroriste. Kjo deklaratë u pasua menjëherë nga një takim tjetër i fshehtë midis Gelbart-it dhe drejtuesve të UÇK-së në emigracion, në Zvicër. Koha vërtetoi se nëse UÇK-ja nuk do të kishte nisur veprimet e saj luftarake, as NATO-ja nuk do të ndërhynte në Kosovë. Por ndërhyrja e NATO-s dhe qëndrimi i politikës amerikane pro shqiptarëve për një Kosovë të pavarur, ishte vendimtare. Qëndrimin tim në mbështetje të UÇK-së si një formacion djemsh dhe burrash që luftonin për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të familjeve të tyre ndaj gjenocidit serb, ia kam përsëritur edhe ambasadorit amerikan Jim Dobbins, më 21 mars 2001, në një takim që patëm ne, anëtarët e Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, në Departamentin e Shtetit Amerikan. Thesova se ishte gabim nga pala amerikane cilësimi i ushtarëve të lirisë në Maqedoni si terroristë. Nuk kaloi shumë kohë dhe qeveria amerikane e përkrahu luftën e shqiptarëve në Maqedoni, njësoj si në rastin me UÇK-në në Kosovë. Qeveria amerikane si gjithmonë u ka qëndruar pranë shqiptarëve dhe, në situata kritike, ka ndërhyrë në favor të tyre. Shqiptarët dhe brezat që do të vijnë do t'u jenë përherë mirënjohës Amerikës, politikanëve, diplomatëve, por dhe popullit të saj.

Si arritët ju bashkë me Këshillin Shqiptaro-Amerikanë, që ta bindnit presidentin amerikan Bill Clinton dhe zyrtarët e lartë ta ndaloni këtë gjenocid?

Ekrem Bardha: Zhvillimet në Kosovë ishin të dhembshme, ndërsa diaspora në ShBA bënte ç'ishte e mundur që t'i përcillte politikës amerikane këtë realitet dhe të kërkonte ndërhyrjen energjike të ShBA-së për t'i dhënë fund luftës. Në këtë situatë, kur çështja e Kosovës ishte kthyer në lajmin e parë të medieve ndërkombëtare dhe vëmendjes së opinionit publik, në mars 1999, Këshilli Kombëtar Shqiptaro-Amerikan i kërkoi një takim presidentit Clinton në Shtëpinë e Bardhë për ta informuar dhe për t'i prezantuar atij fakte se çfarë po ndodhte në Kosovë nga gjenocidi serb. Gjithashtu qëllimi i takimit ishte që



*A private meeting of the Bardha Family with president Bill Clinton.
(Roosevelt, April 11, 1999)*

Familja Bardha në takim privat me presidentin amerikan Bill Clinton

SOVËS (3)

s se do ta ndalte gjenocidin në Kosovë



**President Clinton meeting NAAC leaders
in the White House.
(March 31, 1999)**

Presidenti i ShBA-së, Bill Clinton, në takim me drejtuesit e Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan

të inkurajonim diplomacinë amerikane dhe presidentin Clinton për të shpejtuar ndërhyrjen ushtarake në Kosovë, për shkak se krimi shtetëror serb kishte marrë përmasa masive. Ftesa u pranua menjëherë nga Shtëpia e Bardhë dhe nga zëdhënësi i saj u caktua dita dhe ora e takimit. Nga Këshilli Kombëtar shkuan, përveç meje edhe Ilir Zherka, drejtori ekzekutiv i Këshillit, Avni Mustafa, si dhe anëtarë të bordit drejtues të Këshillit, Hajdar Bajraktari, Dino Erbeli, Bruno Selimaj, Musa Daka dhe Afërdita Rakipi, drejtoreshë e Komunikimit e Këshillit, por dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti, të ftuar nga Këshilli Kombëtar, si Luigj Gjakaj, Agron Gashi, Lavdim Cani dhe Agim Karagozi.

Pasi shumë vend, hapet dera dhe në sallë hyri presidenti Clinton, i cili shoqërohej nga këshilltarët e sigurisë kombëtare, zotërinjtë Sandy Berger, Jim Steinberg, generali George Casey e të tjerë. Që në fillim të bisedës, presidenti tregoi se e kishte mirëpritur këtë takim dhe më shumë interes për temën kërkoi hollësisht dhe fakte konkrete që të informohej rreth gjenocidit serb. Ai u shpreh se kishte bërë takime me persona të cilët kanë një pjesë të familjeve në Kosovë dhe kishte dëgjuar prej tyre raste rrëqethëse, që për mbarë botën ishin të papranueshme se si në zemër të Evropës bëheshin tortura të tilla çnjerëzore ndaj popullatës civile.

Nga ana e Këshillit Kombëtar folën të gjithë anëtarët e tij, ku secili

tregoi me fakte dhe prova se çfarë po ndodhte në Kosovë dhe të gjithë iu lutën presidentit që sa më shpejt të bëhej e mundur një ndërhyrje në Kosovë. Gjithashtu ne paraqitëm shqetësimin lidhur me faktin se serbët po ua digjinin dokumentet e identiteteve shqiptarëve dhe po i detyronin të kalonin kufirin shtetëror. "Vetëm Amerika mund ta ndalte gjenocidin e çmendur serb ndaj shqiptarëve të Kosovës", ishte mesazhi ynë për presidentin Clinton. Ishte një rast i rrallë, mund të thuash, ditë historike për kombin shqiptar, që në zyrën e sigurisë kombëtare të Shtëpisë së Bardhë në Uashington, përfaqësues të diasporës, anëtarë të Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan të diskutojnë me presidentin amerikan për çështjen shqiptare, të zbardhin para njeriut më të fuqishëm të botës masakrat serbe ndaj popullsisë shqiptarë në Kosovë. Takimi përfundoi me sukses. Ne morëm garanci nga vetë presidenti Clinton se gjenocidi serb do të ndalej, ndërsa theksoi angazhimin e tij personal për ndalimin e vrasjeve masive, si dhe lejimin e kthimit të kosovarëve në trojet e tyre. Beogradi do të bombardohej dhe se vetë Millosheviqi do të ndëshkohej nga gjykata speciale për krimet e tij të luftës.

Përse u realizua darka në Paris-Rambuje me ambasadorin Chris Hill?

Ekrem Bardha: E ardhmja e Kosovës po shkruhej në Paris, pikërisht në kështjellën e Rambujesë. E gjithë vëmendja

jonë, por dhe e mbarë botës ishte fokusuar në këto takime mes faktorit ndërkombëtar, politikanëve të Serbisë dhe Kosovës. Vendosa të shkoja në Paris. Miku im, ambasadori Chris Hill, ishte përfaqësuesi kryesor i diplomacisë amerikane në konferencën e Rambujesë. Ai përcillte në konferencë direkt propozimet e presidentit Clinton. Ai e vlerësonte luftën e UÇK-së, gjithashtu e njihte mirë edhe rolin e diasporës. Qëllimi im ishte të flisja me ambasadorin Hill dhe të ndikoja me të gjitha mundësitë e mia që çështja e Kosovës të merrte një rrugë pozitive për shqiptarët. Ishte momenti i shumëpritur, prej vitesh përpjekjeje dhe lobimi deri në nivelet më të larta të politikës amerikane, që ta shihnim dhe ta jetonim më në fund Kosovën të lirë dhe të pavarur.

Sapo arrita në Paris menjëherë rashë në kontakt me Chris Hillin, te cilin e ftova për darkë në restorantin

"Maxim's". Si mik imi dhe i shqiptarëve, ambasadori Hill e pranoi ftesën me kënaqësi. Pak më vonë telefonova shkrimtarin Ismail Kadare, i cili kishte qenë mjaft aktiv dhe kishte ndikuar pozitivisht të pala shqiptare, që bisedimet të përfundonin me sukses e të nënshkruhej marrëveshja. Në bisedë e sipër, Ismaili më thotë se kishte dëshirë të takohej me ambasadorin Hill, meqenëse ai ishte njeriu kyç që mund të ndikonte pozitivisht në bisedimet e Rambujesë. Të gjithë mendohehim në ato ditë të bënim çfarë të ishte e mundur. Ishte një angazhim frontal i faktorit shqiptar, përveç atij ndërkombëtar në favor të shqiptarëve, që nga këto bisedime të mos dillej me deklarata të paqarta dhe me vendime gjysmake.

I thashë Ismailit se e kisha ftuar për darkë ambasadorin Chris Hill dhe nuk mbeti gjë tjetër veçse të caktonim orën. Takimi u la në tetë të mbrëmjes. Në hotelin ku ndodhesha unë, ishte edhe drejtori i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, Avni Mustafa, të cilin e ftova për darkë.

Ismaili shoqërohej nga bashkëshortja e tij, Helena. Zume vend në restorant dhe duke pritur ambasadorin, bisedat tona ishin gjithnjë rreth çështjes së Kosovës dhe të ardhmes së saj.

Ismail Kadare më tha se marrëveshjet e mëdha janë shkruar gjithmonë në Paris, si Konferenca e Versajës, e Janarit 1919 pas Luftës së Parë Botërore dhe Konferenca e Paqes, tetor 1946 pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe fati i Kosovës do të nënshkruhet aty ku janë nënshkruar fatet e të gjitha kombeve në Evropë dhe më gjerë. Nuk mund ta fsheh se vonesa e ambasadorit Hill po na shqetësonte, shqetësim që lidhej me zhvillimet orë pas ore që ndodhnin në Rambuje. Vonesat në fakt nuk janë shenja të mira. Këtë e shprehu edhe Ismaili. "Vonesa, zoti Bardha, nuk është shenjë e mirë", më tha Ismaili, por unë e qetësova, duke i thënë se po të mos vinte, ambasadori Hill do të më kishte lajmëruar me telefon. Në orën tetë e dyzet minuta, Chris Hill u shfaq në hyrje të restorantit së bashku me bashkëshorten. Na kërkoi të falur për vonesën, pastaj na tregoi se po atë natë kishte qenë i ftuar për një koktej nga delegacioni

zyrtar kosovar. "E di që do t'u mbetet hatri që u largova, por tryeza e miqve që më presin është shumë më e rëndësishme për mua", u kishte thënë Hill organizatorëve të koktejit dhe ishte larguar për të ardhur në takimin që kishim bashkë. U përshëndetëm si miq të vjetër, ndërsa ngjarjet në Kosovë ishin në qendër të bisedës sonë. Ne pyetëm se cili ishte qëndrimi i palës amerikane për të gjetur zgjidhje ndaj situatës në Kosovë. Deri ku do të shkonte këmbëngulja amerikane për të zmbarsur serbët nga Kosova?! Si Kadareja, ashtu edhe unë, i kërkuam ambasadorit ndërhyrjen sa më parë të Qeverisë amerikane në Kosovë, pasi situata ishte tepër e rëndë dhe konflikti mund të përhapej në Ballkan. Shqetësimi ynë ishte se mbledhja në Rambuje nuk do të përfundonte me një marrëveshje midis palëve, pasi Jugosllavia nuk do t'i pranonte kushtet e vendosura nga shtetet perëndimore.

Ambasadori Hill na njohu, brenda kornizave që i lejonte misioni diplomatik që kishte, se serbët po synonin vetëm të zvarritnin negociatat pa qëndrime të qarta, ndërsa ShBA-ja ishte e vendosur të mos e pranonte më këtë shtyrje të bisedimeve pa një rezultat. Ambasadori Hill na siguroi se, "nëse Jugosllavia nuk e nënshkruante marrëveshjen, NATO-ja do të fillonte menjëherë bombardimet". Sytë tanë shkëlqyen nga ngazëllimi kur dëgjuam me veshët tanë këtë deklaratë. Ishte një burim i sigurt që duhej besuar dhe ne, personat në tavolinë ishim të parët që e mësuan këtë sihariq për çdo shqiptar. Kadareja më tha: "More Ekrem, a mund ta besosh një gjë të tillë?! Për mua është e jashtëzakonshme dhe e pabesueshme!". Tashmë pritej vetëm vendimi dhe vërtet ashtu ndodhi. Marrëveshja u nënshkrua vetëm nga delegacioni shqiptar. Vetëm nëntë ditë më vonë nga ajo darkë, më 24 mars 1999, bombat e para të NATO-s ranë mbi Beograd. Shqiptarët kudo ndodheshin në botë e pritën lajmin me gëzim të madh. Aleanca më e madhe politike dhe ushtarake në botë, NATO dhe aleati më i madh i shqiptarëve, Amerika, ishin në krah të shqiptarëve për t'i dhënë fund pushtimit serb dhe gjenocidit të tmerrshëm ndaj shqiptarëve.

(Vijon)



Ekrem Bardha dhe Ismail Kadare në takim me Christopher Hillin në Rambuje

Presidenti Trump dhe mesazhet kërcënuese ndaj Iranit

UASHINGTON, 24 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump thotë se nuk është aspak i shqetësuar se mesazhi i tij i së dielës me kërcënime për Iranin do ta provokojë qeverinë iraniane. Presidenti iu përgjigj një gazetari në Shtëpinë e Bardhë kur u pyet për mesazhin e tij në

"Twitter", i shkruar i gjithi me gërma të mëdha, ku ai paralajmëronte ashpër presidentin iranian Hassan Rouhani që të "mos kërcënonte kurrë Shtetet e Bashkuara", përndryshe Republika Islamike do të vuante pasoja historike. Këshilltari i Sigurisë Kombëtare,

John Bolton, tha se kishte folur me Trumpin në ditët e fundit dhe presidenti "i kishte thënë se nëse Irani bën diçka të keqe, do të paguajë një çmim që nuk e ka paguar kurrë ndonjëherë më parë". "Ai po përpiket ta largojë vëmendjen nga shumë lajme të këqija që e rrethojnë."

Ishte disi e ekzagjeruar, por nuk më habit", tha Barbara Slavin, drejtoreshë e nismës "E ardhmja e Iranit" në Këshillin e Atlantikut. Irani e shpërfilli mesazhin e Trumpit. Ministri i Jashtëm, në një postim të vetin po në "Twitter", shkruante "Nuk na bën përshtypje".



je". Trumpi duket se iu përgjigj Rouhaniit, i cili e paralajmëronte "të mos luante me bishtin e luanit, se do të pendohej".

Zjarri në Athinë merr jetën e 75 personave

Deri në orët e vonë të së martës në mbrëmje është raportuar se nga zjarri i madh që përfshiu Athinën mbi 75 persona kanë vdekur, qindra janë plagosur dhe po kaq të humbur, për të cilët ende nuk dihet asgjë. Kryeministri grek Alexis Tsipras ka shpallur tri ditë zie kombëtare



© Reuters/A. Konstantinidis

ATHINË, 24 KORRIK - Athina po përballet me një nga rastet më të rrezikshme të zjarrit që ka përfshirë lagje të tëra të kryeqytetit grek dhe ka djegur e shkatërruar shumë banesa. Deri tani raportohen mbi 75 persona të vdekur, qindra të plagosur dhe po kaq të humbur, për të cilët ende nuk dihet asgjë. Në lidhje me këtë ngjarje të rëndë ka reaguar edhe kryeministri Alexis Tsipras. Ai ka njoftuar tri ditë zie kombëtare për të humburit në tragjedi dhe ka bërë thirrje që njerëzit të mobilizohen e solidarizohen me Greqinë. "Nuk ka fjalë për t'i përshkruar ndjenjat e të gjithë neve në çast të tilla. Vendi jeton një tragjedi të patreguar më parë, pasi janë humbur dhjetëra jetë njerëzish dhe kjo është e padurueshme për të gjithë. Më shumë për familjet që humbën të dashurit e tyre, por edhe për ata prej nesh që janë në pozita


përgjegjësie", tha Tsipras. Ai tha se për ata që kuptojnë se nuk ka asgjë më të çmuar sesa jeta e njeriut. "Sot Greqia është duke mbajtur zi dhe në kujtesën e atyre që kanë humbur jetën, shpallim një zi kombëtare treditore. Por ne nuk duhet të lejojmë që zia të na mposhtë për shkak se këto kohë orë luftarake, uniteti, guximi dhe mbi të gjitha solidariteti. Sepse vetëm kështu, së bashku, mund të qëndrojmë kundër tragjedisë. Greqia po përjeton një test të madh. Tani është koha e mobilizimit dhe luftës. Lufta për të shpëtuar atë që mund të shpëtohet. Lufta për të mundur zjarrin, gara për t'i gjetur të zhdukurit", ka thënë kryeministri grek Alexis Tsipras. Shumë vende të botës kanë shprehur solidaritetin dhe gatishmërinë e tyre për ta ndihmuar Greqinë për përballimin e kësaj situate. Athina i kërkoi ndihmë Bashkimit

Evropian për betejën me zjarret. Greqia tha se Qiproja ka ofruar zjarrfikës, ndërsa Spanja një avion kundër zjarreve. BBC raportoi se vende si Italia, Gjermania, Polonia dhe Franca dërguan avionë, makina dhe zjarrfikës. Zjarri i parë shpërtheu në një pyll pishash afër qytetit të vogël të Kinetës, 50 kilometra në perëndim të Athinës. Tri komunitete u evakuuan, ndërsa flaka mbylli një pjesë prej rreth 20 kilometrash të një autostrade të

madhe. Temperaturat e larta dhe erërat me shpejtësi deri në 80 kilometra në orë po pengojnë përpjekjet për shuarjen e zjarreve. Një zjarr tjetër goditi në verilindje të Athinës, në zonën Penteli, duke përparuar drejt qytetit të Rafinës. Kryebashkiaku i Rafinës tha se të paktën 100 shtëpi janë shkatërruar. Roja bregdetare greke dërgoi anije në zonë për t'i evakuuar banorët e bllokuar në plazhe. Ajo është vënë në kërkim të një anijeje që u

raportua e zhdukur dhe për të cilën u tha se po bartte turistë danezë që po iknin nga zjarret. Shefi i zjarrfikësve lokalë bëri thirrje përmes televizionit që njerëzit të iknin nga zona, meqë disa kanë bërë përpjekje të qëndrojnë në pronat e tyre. "Njerëzit duhet të iknin dhe t'i mbyllin shtëpitë. Njerëzit nuk mund të durojnë kaq shumë tym për disa orë. Kjo është një situatë e jashtëzakonshme", tha Achilles Tzouvaras.

Erdogani: Izraeli është shteti më racist në botë



Ankara, 24 korrik - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka dënuar Izraelin, duke e cilësuar si shtetin më racist në botë. Presidenti turk ka thënë se shpirti i Adolf Hitlerit është "ringjallur", pasi Izraeli miratoi një ligj ku thuhet se ky shtet është atdhe i veçantë për popullin hebre. "Nuk ka asnjë dallim në mes të obsesionit të Hitlerit me racën ariane dhe këndvështrimin të lidhshëm të Izraelit se kjo tokë e lashtë u takon vetëm hebrenjve", u shpreh

Erdogani, raporton DPA. "Shpirti i Hitlerit, i cili çoi botën në një katastrofë, është ringjallur në mesin e disa autoriteteve izraelite", shtoi ai. Ligji i ri i miratuar nga Izraeli "shpërfaq qëllimin e vërtetë të këtij shteti", ka thënë Erdogan. Komentet e presidentit turk janë të parat që prej se Izraeli miratoi ligjin javën e kaluar. Lidhur me këto komente ka reaguar kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu. "Fakti që

një 'demokrat' i madh si Erdogan sulmon Ligjin për komb, është komplimenti më i madh që i bëhet këtij ligji. Turqia, nën sundimin e Erdoganit, është bërë një diktaturë e errët, ndërsa Izraeli ruan të drejtat e barabarta për të gjithë qytetarët", ka thënë kryeministri izraelit përmes një deklarate. Ligji i miratuar e njeh Izraelin si shtet hebre dhe thotë se "e drejta për të ushtruar vetëvendosje kombëtare në shtetin e Izraelit është unike për popullin hebre".

May: Unë do t'i udhëheq negociatat për Brexitin

LONDËR, 24 KORRIK - Kryeministria britanike Theresa May ka thënë se ajo do t'i udhëheqë bisedimet me Bashkimin Evropian, duke zhvendosur fokusin e departamentit të Brexitit drejt përgatitjes për largimin e Britanisë nga blloku. Një njësi e posaçme brenda zyrës së May ka marrë

pjesë në bisedimet për Brexitin muajt e fundit dhe njoftimi i sotëm vetëm sa ka formalizuar ndryshimin, sa i përket personit që tash do t'i marrë përgjegjësitë për udhëheqjen e negociatave, raporton agjencia "Reuters". "Unë do t'i udhëheq negociatat me Bashkimin Evropian, së

bashku me sekretarin për Daljen nga Bashkimi Evropian, Dominic Raab", ka thënë May përmes një deklarate me shkrim drejtuar Parlamentit. "Departamenti për Daljen nga BE-ja do të vazhdojë t'i udhëheqë të gjitha përgatitjet e Qeverisë për Brexitin", thuhet tutje në

deklaratë. Më herët, negociatat për daljen e Britanisë nga BE-ja i ka udhëhequr David Davis. Ai ka dhënë dorëheqje muajin e kaluar, në shenjë proteste për strategjinë e negociatave për Brexitin të prezantuar nga kryeministria Theresa May.



E jashtëzakonshme

Trendi i ri, masazh me piton

Nju Jorku njihet si vendi i shërbimeve më ekzotike. Më 16 korrik u festua Dita Ndërkombëtare e Gjarprit. Pikërisht këtë ditë, CBS Nju Jorku u takua me Serpentes, e cili jep masazhe relaksues me gjarpër. Disa njerëz kanë frikë nga gjarpërinjtë, të tjerë i ngatërrojnë me kafshë shtëpiake. Serpentes është 33-vjeçare dhe ka 25 vjet që trajnon



gjarpërinjtë, prandaj ofroi këtë shërbim në ShBA për 300 dollarë për 90 minuta.

FOTO E DITES



Atletët notojnë nga Azia në Evropë në ngushticën e Bosforit gjatë garës së gjelbër të Bosforit në Stamboll. /AP/

E rrallë

Pensionistja denoncon për vjedhje, por donte shoqëri nga policia

"Ejani shpejt, ka hajdutë"! Kështu ishte deklaruar përmes telefonit pensionistja 81-vjeçare në Itali, e cila kishte thirrur policinë për të denoncuar një vjedhje në shtëpinë e saj. Patrulla vajti në 'vendngjarje' dhe pas një verifikimi të shpejtë, kuptoi se bëhej fjalë për një alarm fals. E moshuara kërkoi ndjesë duke qarë dhe duke jus-



tifikuar kërkesën për ndërhyrje të një patrulle me faktin se ndihej shumë e vetmuar.

BARSOLETA E DITËS



Tragjedia

"Alo, babi! Jemi në gomone dhe po mbytemi".
"Mirë, mirë, të keqen babi, po mbylle telefonin e mos harxho lekë".



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit
në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



Në ora 18:20

"FUTURE WORLD"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed




Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Propozimet tuaja do të ngjallin dyshime sot.

Duhet të tregoheni më këmbëngulës për të arritur atë që doni.



DEMI

Edhe pse mund të keni zhgënjyer persona të

caktuar sot, ajo që duhet të bënit është më e rëndësishme se gjithçka.



BINJAKËT

Edhe pse karriera ju shqetëson në këto momente,

duhet të dini që nuk mund të zaptojë gjithë kohën tuaj.



GAFORRJA

Sot do të bashkëpunoni me persona të tjerë në

realizimin e një projekti. Po eksperimentoni disa metoda që ju interesojnë.



LUANI

Keni lejuar disa persona që t'ju thonë se

çfarë dhe si duhet ta bëni një gjë. Tani preferoni që t'i zgjidhni vetë problemet tuaja.



VIRGJËRËSHA

Po nervozoni personat pranë jush që

do të preferonin të kaloni orë të këndshme në shoqërinë tuaj jo t'ju jepnin shpjegime të kota.



PESHORJA

Mbase po i kushtoni më shumë rëndësi seç duhet një situatë të caktuar. Në këtë ditë ju nevojitet të merrni vendime të prera.



AKREPI

Po lini pas vetes shumë çështje të pazgjidhura dhe shumë dyshime si në anën profesionale ashtu edhe në atë personale.



SHIGJETARI

Planet tuaja për ditën e sotme do të modifikohen nga personat që janë pranë jush. Kjo është një gjë mjaft e mirë, sepse do të kënaqeni më shumë.



BRICJAPI

Duke ndenjur dhe duke u menduar pa fund mos kujtoni se do të zgjidhni problemet që ju shqetësojnë. Pak initiative për të lëvizur do t'ju bënte mirë.



UJORI

Dita e sotme do të shkojë shumë më keq se sa e kishit menduar. Mjafton mos t'ju mposhtë pesimizmi.



PESHQIT

Nëse doni të vazhdoni të harxhoni kohë me gjëra të kota është në dorën tuaj. Bëni mirë t'i kushtoni më shumë kohë familjes tuaj.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

AJAX - SK STURM GRAZ

1

CELTIC - ROSENBORG

GG3+

KUKESI - QARABAGH

GG

Elezaj: Dukagjini i vendosur për Superligë

Dukagjini i Klinës, me transferimin e yjeve Mark Milicaj, Dugagjin Gashi, Granit Arifaj dhe Altin Merlaku, ka konfirmuar se synon ta shkruajë historinë në futbollin e Kosovës, duke u inkuadruar për herë të parë në elitë. "Emrat të cilët i kemi ofruar në klubin tonë janë vërtet futbollistë të njohur tashmë për opinionin sportdashës në Kosovë. Besoj se do t'ia arrijmë synimit të inkuadrohemi në Superligë pas ardhjes së Milicajt, Gashit, Hajrizajt, Arifajt, Merlakut, Beqirit dhe Malokut, pa harruar edhe lojtarët vendorë të cilët janë shumë të talentuar", ka thënë Severin Elezaj

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 KORRIK - KF Dukagjini e ka bërë një organizim të jashtëzakonshëm pas përfundimit të edicionit 2017/2018 me qëllim të inkuadrimin në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Trajneri Severin Elezaj të martën për "Epokën e re" ka folur për atmosferën në skuadrën nga Dukagjini, duke thënë se është e jashtëzakonshme, për faktin se futbollistët vendorë janë mjaft mikpritës. "Për atmosferën në si klub jemi kujdesur çdoherë që të jetë e përshtatshme për çdo futbollist. Këtë gjë e kemi arritur të gjithë së bashku si kryesi, staf i trajnerëve dhe futbollistët vendorë që vërtet janë të talentuar dhe mirëpritës për të gjithë që ia duan të mirën klubit. Ardhjet e reja e kanë shtuar entuziazmin dhe konkurrencën në klub, që është një gjë shumë pozitive", ka thënë ai. Dukagjini ka bërë transferime të mëdha

në këtë afat kalimtar duke arritur marrëveshje me Mark Milicajn, Dugagjin Gashin, Granit Arifajn dhe futbollistë të tjerë, kurse trajneri Elezaj konfirmon se inkuadrimi në elitë është qëllimi i të gjithëve në klub. "Emrat të cilët i kemi ofruar në klubin tonë janë vërtet futbollistë të njohur për opinionin sportdashës në Kosovë. Besoj se do t'ia arrijmë synimit të inkuadrohem në Superligë pas ardhjes së emrave si Milicaj, Gashi, Hajrizaj, Arifaj, Merlaku, Beqiri dhe Maloku, por pa harruar edhe lojtarët vendorë të cilët janë shumë të talentuar", ka thënë, ka thënë Elezaj. Skuadra nga Klina e ka zhvilluar një ndeshje miqësore me skuadrën e Trepçës '89 dhe tash pritët të zhvillojë edhe ndeshje të tjera miqësore. "E falënderoj 89-shin për pritjen dhe ftesën për ndeshjen miqësore, kurse ne planifikojmë të zhvillojmë edhe disa ndeshje të tjera. Për këtë jemi në kontakt me klube nga Liga e Parë dhe Superliga. Ndërsa sa iu përket

përgatitjeve, jemi në kërkim të një vendi sa më të përshtatshëm", ka shtuar ai. "Për këtë organizim të mirë ka ardhur përkrahja e kryetarit të Klinës, prof. Zenun Elezaj, kryetarit të klubit, Binak Kalludra, si dhe nga njeriu që vërtet po bën shumë për futbollin klinas, drejtori i klubit, Fabian Veselaj dhe kryesia në përgjithësi", ka deklaruar ai.

Në fund Elezaj ka folur edhe për skuadrat që janë pretendente për inkuadrim në elitë. Ai ka thënë se Vëllaznimi, Besa dhe Vushtrria janë skuadrat që do ta kenë fjalën kryesore në Ligën e Parë. "Është pak herët të flitet për skuadrat pretendente, por mendoj se pa e përmendur Dukagjinin kemi skuadra vërtet shumë të mira dhe do të jetë një garë e nxehtë dhe shumë interesante. Në këtë garë do të hyjnë klube që vërtet janë të organizuara mirë dhe me lojtarë shumë të talentuar si Vëllaznimi, Besa, Vushtrria, pa harruar edhe klubet e tjera që kanë organizim dhe lojtarë të mirë në radhët e tyre", ka përfunduar Elezaj.

SHKURT

Bashkimi përforcohet me amerikanen Mari Stewart

KB Bashkimi në konkurrencën efemrave e ka transferuar basketbollistin amerikane Mari Stewart, e cila sezonin e kaluar ishte pjesë e West Virginia Wesleyan dhe kishte një mesatare 14.1 pikë dhe 9.3 kërcime për ndeshje. Bashkimi në kampionatin e kaluar u shpall kampion, pasi në garat e "play-off"-it mposhti ProBet Prishtinën në gjysmëfinale dhe Penzën në finale.

Ja lista për trajnerë të vitit nga FIFA

11 trajnerë janë emëruar kandidatë për ta fituar çmimin "Trajneri i Vitit" nga FIFA. Ish-trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, është pjesë e kësaj liste pas triumfit në Ligë të Kampionëve gjatë edicionit të shkuar, ndërsa në këtë listë është bashkëkombësi i tij, Didier Deschamps, i cili e fitoi Kupën e Botës me Francën. Lista e trajnerëve: Massimiliano Allegri, Stanislav Cherchesov, Zlatko Daliq, Didier Deschamps, Pep Guardiola, Jurgen Klopp, Roberto Martinez, Diego Simeone, Gareth Southgate, Ernesto Valverde, Zinedine Zidane.

Milani kërkon Igli Taren

AC Milan po riformatohet pas ndryshimit të pronësisë. Kuqezinjtë janë vënë në lëvizje për një drejtor të ri të sportit. "Milan News" raporton se në orët e fundit Igli Tare ka marrë kryesimin në këtë garë. Tare aktualisht është drejtor sportiv i Lazios dhe fitues i disa çmimeve për punën e tij me talentet.

Paralajmërimi i Kloppit: Koha të fitojmë trofe

Skuadra e Liverpoolit e ka fituar për herë të fundit EFL Cup në vitin 2012, kurse kampionati mungon që prej 1990-s. Trajneri Jurgen Klopp është i bindur se ka ardhur koha që skuadra nga "Anfield" të fitojë trofe. "Liverpooli duhet të fillojë të fitojë trofe. Ky është hapi i radhës dhe duhet të jemi gati për këtë. Jam i bindur se mund të vazhdojmë aty ku e lamë sezonin e kaluar", ka deklaruar Kloppi. Skuadra e Liverpoolit në këtë afat kalimtar ka transferuar yjet si Shaqiri, Alisson, Fabinho dhe Keita.

Shtatë futbollistë largohen nga Prishtina

PRISHTINË, 24 KORRIK - FC Prishtina i ka transferuar gjashtë futbollistë në këtë afat kalimtar: Armend Thaqin, Ahmet Halitin, Leotrim Bekteshin, Argjend

Mustafën, Meriton Korenicën dhe Alen Jasharovskin, kurse nga huazimi janë rikthyer edhe Donat Hasanaj e Leonat Vitija nga KEK-u. Deri më tash janë

larguar shtatë futbollistë: Lorik Maxhuni, Ben Nash Quansah, Gentrit Dumani, Dardan Sekiraqa, Blend Baftiu, Drashko Bozhoviq, Shqiprim Taipi. FC

Prishtina i ka falënderuar futbollistët e larguar për kontributin e dhënë në ekip dhe u dëshiron karrierë të suksesshme në vazhdim.



Kalendari i La Ligas, Barça - Real takohen më 28 tetor

MADRID, 24 QERSHOR - Asambleja e Përgjithshme e Federatës Spanjolle të Futbollit ka miratuar të martën kalendarin e La Ligas për sezonin 2018-2019. Shorti është hedhur përmes një sistemi të ri kompjuterik. Një kalendar që është asimetrik, që do të thotë se rendi i ditëve të fazës së parë nuk do të jetë i njëjtë me atë të fazës së dytë. Kujtojmë se sezoni i ri i La Ligës filon më 18 gusht. Kampionët katalanas në fuqi e nisnin në "Camp Nou", kundër Alaves, ndërsa Atletico Madridi do të jetë mysafir në "Mestalla", duke sfiduar Valencian në ndeshjen më të mirë të javës së parë. Real Madridi pret në shtëpi Getafe. Barcelona dhe Real Madridi do të takohen për herë të parë në sezonin e ri në javën e 10 (28 tetor) në "Camp Nou". "Classico" e fazës së dytë do të luhet në javën e 26 (3 mars). Derbi i Madridit mes Realit dhe Atletico do të luhet në "Bernabeu" në javën e 7-të (30 shtator) dhe kthimi në "Wanda Metropolitan", javën e 23 (10 shkurt). Derbi i Katalonjës mes Barcelonës dhe Espanyol do të luhet në "Cornellà", në javën e 15-të (9 dhjetor), ndërsa kthimi në "Camp Nou", javën e 29-të (31 mars). Barcelona do ta përfundojë kampionatin e ardhshëm në "Ipurua", duke u përballur me Eibarin. Real Madridi, nga ana tjetër, do ta për-



fundojë në "Santiago Bernabeu", duke luajtur kundër Betisit, ndërsa Atletico Madridi do të jetë duke luajtur në "Ciutat de Valencia" kundër

Levantes. Dueli më tërheqës i javës së fundit të La Ligës, sezonin e ardhshëm, do të jetë Sevilla-Athletic.

JAVA E PARË - 19 GUSHT

Athletic-Leganés
Betis-Levante
Celtic-Espanyol
Eibar-Huesca
Girona-Valladolid
Ray-Sevilla
Barcelona-Alaves
Valencia-Athletic
Real Madrid-Getafe
Villarreal-Real Sociedad

JAVA E FUNDIT - 19 MAJ

Alaves-Girona
Celta-Rayó Vallecano
Espanyol-Real Sociedad
Getafe-Villarreal
Huesca-Leganés
Sevilla-Athletic
Levante-Athletic Madrid
Eibar- Barcelona
Real Madrid-Betis
Valladolid-Valencia

Carmelo Anthony përforcon Houstonin

Houston, 24 korrik - Carmelo Anthony do të jetë lojtari më i ri i Houston Rocketsit. Ish-lojtari i New York Knicksit pritet të nënshkruajë për një vit e do të përfitojë 2.4 milionë dollarë. Nëse nuk ka pengesa të tjera gjatë rrugës, Anthony do të jetë pjesë e një ekipi që vjet për pak sa nuk preku finalen e madhe të NBA-s, pasi u mund në serinë finale të Perëndimit 4-3 nga Golden State Warriors. Ajo çfarë shqetëson tifozët e Rocketsit është se sa do të jetë i aftë 34-vjeçari të përshatatet në një skuadër ku nuk është pika e referimit në sulm. Në sezonin që lamë pas ai pati paraqitjen më të dobët në karrierë me Oklahoma City Thunderin, duke shënuar një mesatare prej 16.2 pikësh për ndeshje. Gjithsesi, mjaft i entuziazmuar është dukur "ylli" i ekipit të Houstonit, James Harden, kur u pyet për afrimin e



mundshëm të Melos në skuadër: "Do të jetë një blerje shumë e mirë për ne. Përvoja e tij është e madhe e në këtë pikë të karrierës së tij ai ka shumë

dëshirë të fitojë. Përveç kësaj, edhe ekipi aktual është i fortë dhe kemi dëshirë të ecim përpara. Melo do të na ndihmonte shumë në lidhje me këtë".

SHKURT

Bologna transferon lojtarin nga Malisheva

Lirim Kastrati nga Turjaka e Malishevës, i cili është produkt i shkollës së futbollit të Romës në Itali, ka nënshkruar me klubin tjetër italian, Bologna. Sipas "TuttoMercatoWeb.com", Bologna ka arritur marrëveshjen për ta blerë lojtarin e Kosovës, i datëlindjes 1999, dhe për të firmosur me të një kontratë trevjeçare. Kastrati është një lojtar që është rritur te Roma dhe luan në qendër të mbrojtjes, por edhe në krahun e djathtë. Kastrati është pjesë edhe e Përfaqësueses së Kosovës.

Aston Villa e dëshiron Henryn trajner

Ish-kampioni botëror dhe evropian me Francën, në vitet 1998 dhe 2000, Thierry Henry, tash asistent i trajnerit të Belgjikës, Roberto Martinez, mund të bëhet trajner i ri i Aston Villës. "Daily Star" e zbulon këtë. Ish-sulmuesi francez, i cili ka veshur fanellën e Arsenalit për vite në Premierë Ligë, tashmë është kontaktuar joformalisht nga klubi i Birminghamit. Megjithatë, para se ta angazhojë francezin e njohur në drejtim, Aston Villa, një ekip që luan në Premiership, do të duhet ta zgjedhë kontratën me trajnerin e vet aktual, Steve Bruce.

Tottenhami "ëndërron" rikthimin e Modriqi

Tottenham Hotspur po synon ta rikthejë ish-mesfushorin, Luka Modriq, raporton "Don Balon". Ky transferim duket i përzgjedhur për faktin se Real Madridi nuk dëshiron të heqë dorë nga kroati, i cili ka shkëlqyer në Kupën e Botës "Rusi 2018". Luka Modriqi në vitin 2012 u transferua nga Tottenhami në Real për një shumë prej 40 milionë eurosh.

61 milionë euro nuk mjaftojnë për Willianin

Chelsea edhe një herë e ka refuzuar ofertën e Barcelonës për yllin brazilian Willian. "Sky Sports" raporton se oferta e tretë e Barcelonës është 61 milionë euro, por as kjo nuk është pranuar nga drejtuesit e klubit anglez, pasi ata janë të bindur se Willian ka vlerë 80 milionë euro.

Bonucci rikthehet te Juve?

Leonardo Bonucci mund të rikthehet sërish te Juventus. Lajmin e ka bërë me dije "La Gazzetta Dello Sport", e cila konfirmon se mbrojtësi një gjë të tillë e kishte menduar edhe në afatin kalimtar të janarit. Në anën tjetër, Milani ka shfaqur interesim për sulmuesin Gonzalo Higuain dhe mund të ndodhë një shkëmbim i futbollistëve në mes dy skuadrave të mëdha italiane.

Wolverhamptoni, afër marrëveshjes me Pepen

Ish-anëtar i Real Madridit, Pepe, pritet të largohet nga Turqia vetëm pas një viti. Mediet në ishull raportojnë të martën se mbrojtësi portugez do ta braktisë skuadrën e Beshiktashit për t'i bashkuar Wolverhamptonit në Premierë Ligë. 35-vjeçari shihet si një garanci për repartin e mbrojtjes në skuadrën e saporikthyer në elitën e futbollit anglez.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
NOTIFICATION ON SEALED BID SALE
OBAVEŠTENJE O PRODAJI ZATVORENIM PONUDAM**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyruar e Tatimit.

Under the Law No. 03/L-222 Article 34 the property described below has been seized for nonpayment of taxes due Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar në “Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat” dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37.

